E martë, 26 tetor 2021

[Seancë e hapur]

[I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur të gjithë.

Znj. Sekretare thërrisni çështjen ju lutem.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Vë re se sot ka ardhur përsëri z. Pace. Ka ndonjë ndryshim tjetër? Jo.

Z. Rees, ndonjë shtesë?

Z. REES: [Përkthim] Znj. Stephenson është kthyer dhe është në Gjykatë.

Z. CADMAN: [Përkthim] Dhe znj. Chelsea Qu gjithashtu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vë re se z. Haradinaj dhe z. Gucati janë të dy të pranishëm në sallën e gjyqit.

Përpara sesa të sjellin dëshmitarët, Trupi Gjykues do të vë në dukje disa gjëra. Vëmë në dukje se Prokuroria ka parashtruar dje parashtrimet e saj për provat e lidhura me çështjen siç i kemi urdhëruar javën që shkoi. Ka numër F397 [sipas përkthimit].

Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen të vë në dukje me gojë ose me shkrim se cilat nga këto prova ajo kundërshton gjatë pyetjeve.

Z. Rees, Z. Cadman duke supozuar se pyetjet do të mbarojnë sot presim të marrim një parashtrim me shkrim sot.

Z. REES: [Përkthim] Do të bëjmë parashtrim me gojë. Kjo ju jep kohë sepse keni më shumë kohë. Do t'i dëgjojnë më mirë parashtrimet tuaja kur të vinte faza e parashtrimeve.

Z. Cadman, keni fjalën.

Z. CADMAN: [Përkthim] Përpara se të vijë dëshmitari kam një çështje. Neve e kishim dorëzuar një kërkesë për shtesën e një dëshmitari, jo për të vonuar çështjen por duhet që t'i japim udhëzime me shkrim dëshmitarit. Por duhet të marrim prej jush miratim nëse na lejoni apo jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'u kthejmë përgjigje. Faleminderit që na njoftuat.

Siç i tha, Trupi Gjykues vë në dukje se Mbrojtja do të përgjigjet për F397 [sipas përkthimit] lidhur me dëshmitarin ekspert dhe për listën e dëshmitarëve të vet. Në emër të shpejtësisë së procedurave, Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen e Haradinaj, pa dëgjuar nga ZPS-ja për kërkesën konkrete të parashtrojë raportin e vet deri në 9 nëntor. Prokuroria udhëzohet të ndjekë procedurën e parashtruar në rregullin 149(2) dhe të parashtrojë çdo njoftim brenda 7 ditësh nga njoftimi i raportit. Kjo përfundon urdhrin me gojë lidhur me

raportin për dëshmitarin e ri ekspert.

Z. CADMAN: [Përkthim] Koha është e pranueshme, afati kohor. Duke pasur parasysh se ZPS-ja ka ngritur kundërshtime lidhur me ekspertin e ri për sa i takon materialit duhet t'i japim atij për tuaj përgatitur, me kënaqësi mund të bashkëpunojmë me Prokurorinë për dokumente, të cilat duhet t'i jepen këtij eksperti.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjithmonë e inkurajojmë këtë bashkëpunim. Faleminderit shumë.

Tani të vazhdojmë me Dëshmitaren.

Ju lutemi silleni Dëshmitaren në sallën e gjyqit.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni znj. Pumper.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes. Sot Mbrojtja do të vazhdojë dhe do të përfundojë pyetjet e saj. ZPS-ja vuri në dukje se dëshiron t'ju bëjë disa pyetje plotësuese. Pastaj anëtarët e Trupit Gjykues mund të kenë pyetje. Plani është që dëshmia juaj të përfundojë sot.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Cadman, keni fjalën.

DËSHMITARJA: [Përkthim] ZDENKA PUMPER [Vijon]

Pyetje të palës tjetër nga Z. Cadman:

Py. Mirëmëngjes, znj. Pumper.
Pë. Mirëmëngjes.

Py. Siç vuri në dukje z. Rees, përpara se të fillonte pyetjet e veta edhe unë do të them të njëjtën gjë. Nëse ka diçka që nuk e kuptoni, që nuk mund t'ju përgjigjeni, ju lutem thojeni këtë, vëreni në dukje.

Pë. Faleminderit.

Py. Do të bëj më të mirën time që t'i përmbahem qëndrimit tonë se nuk kemi dëshirë të vemi në seancë private. Por sigurisht në pritje të udhëzimeve të Trupit Gjykues, mund të ketë momente që do të na duhet të shkojmë, shkurtimisht në seanca private nëse bëhet fjalë për emra. Disa gjëra për t'i sqaruar si fillim. Është e vërtetë që ju nuk keni qenë e pranishme në sekuestrimin dhe kontrollin e bërë në 8, 17 dhe 20 shtator [sipas përkthimit].

Pë. Po.

Py. Dhe në 25 shtator, kur ju kryesuat operacionin e kontrollit që pamë dje, nuk patët ndonjë kontakt as me z. Haradinaj, as me z. Gucati?

Pë. Fola me z. Gucati.

Py. Po ai nuk ishte i pranishëm gjatë operacionit të sekuestrimit dhe kontrollit.

Pë. Jo.

Py. Dhe është e saktë të themi se në asnjë fazë të punës suaj, as zyrtarisht apo jo zyrtarisht nuk e keni pyetur z. Haradinaj për këto çështje?

Pë. Jo, nuk e kam pyetur.

Py. Dhe nuk keni qenë e pranishme në arrestimin e tij në 25 shtator apo jo, më falni 26?

Pë. Ai u arrestua në datën e kontrollit.

Py. Pyetja është nuk ishe e pranishme?

Pë. U arrestua në OVL-UÇK, besoj që aty isha dhe unë, po. Po nuk u përfshiva në veprimin e arrestimit.

Py. Tani duam të shohim pak historikun tuaj personal, biografinë tuaj të themi. Më parë keni qenë hetuese për disa vite ne policinë austriake.

Pë. Po.

Py. Dhe pas kësaj keni shërbyer në disa misione të Kombeve të Bashkuara dhe të BE-së.

Pë. Në një mision të BE-së.

Py. Mision të BE-së?

Pë. Po.

Py. Së pari kur keni qenë punonjëse e policisë austriake, jeni caktuar në Timorin Lindor në një mision të Kombeve të Bashkuara.

Pë. Po.

Py. Keni shërbyer dhe në DRC, në Haiti, dhe në Bregun e Fildishtë?

Pë. E saktë, e saktë.

Py. Në Timorin Lindor jeni bërë edhe drejtuese e ekipit për hetimin e krimeve të luftës?

Pë. Po.

Py. Dhe në përgjegjësitë tuaja ishin edhe administrimi dhe sigurimi i provave?
Pë. Në një shkallë më të vogël.
Py. Nga 2009 deri në 2015, siç e kuptoj unë keni qenë zëvendës -- punonjëse e policisë në misionin e BE-së për çështje, për hetime financiare.
Pë. Po, në hetime financiare dhe në krimin e organizuar.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkohet të flisni më ngadalë.
Py. Gjatë kohës që keni qenë në Kosovë, keni drejtuar një numër hetimesh komplekse?
Pë. E saktë.
Py. Keni qenë përgjegjëse për përgatitjen e planeve të punës?
Pë. E saktë.
Py. Për analizën e provave?
Pë. E saktë.
Py. Për intervistimin e dëshmitarëve dhe të të dyshuarve?
Pë. E saktë.
Py. Për përdorimin e masave të fshehta?
Pë. Po, e saktë.
Py. Dhe për hartimin e raporteve paraprake dhe përfundimtare hetimore?
Pë. E saktë.
Py. Gjatë kësaj kohe keni ndërmarrë dhe studime akademike në universitet, në universitetin Leicester?

Pë. Po, nga larg.

Py. Keni bërë një master për drejtësinë penale dhe kriminologjinë?

Pë. E saktë.

Py. Pastaj keni shkuar në TFHS ku keni punuar për pesë muaj?

Pë. E saktë.

Py. Gjatë kësaj kohe, keni punuar me David Schwendiman dhe Kwai Hong Ip?

Pë. E saktë.

Py. Në 2016, edhe njëherë me David Schwendiman dhe Kwai Hong Ip keni filluar punë në ZPS dhe tani jeni konsulente e pavarur hetimore?

Pë. A mund ta përsërisni ju lutem sepse nuk e dëgjova.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman dhe znj. dëshmitare ju lutem bëni një pushim mbas pyetjeve dhe përgjigjeve që përkthyesit të mund t'ju ndjekin.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Në vitin 2016, filluat punën në ZPS, e saktë?

Pë. E saktë.

Py. Dhe keni punuar me, nën drejtimin e David Schwendiman dhe Kwai Hong Ip?

Pë. Po.

Py. Tani punoni si konsulente e pavarur hetimore?

Pë. Jo.

Py. Pra posti juaj tani është ai i koordinatores hetimore?

Pë. Unë jam hetimore [sipas përkthimit]. Po brenda zyrës kam rolin e drejtueses së operacioneve hetimore.

Py. Gjatë dëshmisë tuaj kryesore dhe pyetjeve ju thatë që keni 20 vite përvojë si hetuese me përvojë e lart. Besoj që jeni me përvojë?

Pë. Kam 20 vite si hetuese.

Py. Po në këtë rast, prova juaj, ajo dëshmia juaj është që jeni dërguar për të kryer analizën e të dhënave.

Pë. A mund ta specifikoni?

Py. Ju thatë në fakt që u është kërkuar të shqyrtoni tre paketat dhe të konfirmoni nëse ai material ishte në sistemin tuaj ZyLAB.

Pë. Nuk ju kuptova. E keni fjalën. Nuk ju kuptova. Po e saktë është nëse e kishit fjalën për paketat, duhet t'i analizoja.

Py. Kur u bëri pyetje z. Rees, lidhur me analiza të mëtejshme të përmbajtjes të atyre materialeve ti nuk dole nga udhëzimet që të kishin dhënë?

Pë. Jo.

Py. Po kjo nuk përputhet shumë me përvojën tuaj apo jo?

Pë. Nuk ju kuptoj se çfarë thoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj. Është argument ky.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Vazhdoni.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pyetja që kam për ju është kjo. Siç e pamë, jeni një

hetuese me përvojë dhe në këtë rast ju është dhënë i saktë, i rrreptë që të bëni analizën e të dhënave. Pyetja që kam është kjo. Kjo nuk përputhet shumë me vitet tuaja të përvojës si një hetuese me përvojë, një hetuese e lartë.

Pë. Për mua nuk ka asgjë të zakontë të më jepen detyra konkrete. Një herë më jepet një detyrë, një herë një detyrë më e vështirë.

Py. Do t'i kthehemi për një çast arrestimit të z. Haradinaj. Ju thatë që u arrestua në OVL UÇK.

Pë. Mbase nuk u kuptuam. Kisha parasysh z. Gucati.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjja e saj më përpara ishte që z. Gucati u arrestua në praninë e saj.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Kurse pyetja ime ishte në lidhje me z. Haradinaj.

Pë. Ju kërkoj ndjesë, mbase nuk ju dëgjova mirë.

Py. Pra nuk jeni përfshirë në arrestimin e tij?

Pë. Jo, jo të z. Haradinaj.

Py. Në dëshminë tuaj kur ju bëri pyetje z. Rees, thatë se më përpara nuk keni përdorur ndonjë oficer të nxjerrjes.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua t'i thotë t'i drejtohet përgjigjes së saktë të dëshmitares. Nuk tha kështu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Referojuni pyetjes konkrete që iu bë Dëshmitares.

Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, derisa ta gjejmë po ia bëj dhe njëherë pyetjen dëshmitares.

Py. Gjatë angazhimit tuaj në këtë punë, keni pasur ndonjëherë arsye, shkak të përdorni një punonjës që ka të bëjë me nxjerrjes e materialeve?

Pë. E keni fjalën në këtë rast?

Py. Po.

Pë. Duroni pak ju lutem, prisni. Jo, nuk besoj.

Z. CADMAN: [Përkthim] Një moment ju lutem të nderuar Gjykatës.

Py. Do t'i kthehemi asaj referencës në një moment. Por ju thatë se në dëshminë tuaj se, kur morët paketën e tretë të materialeve, e keni marrë nga punonjësi që merret me administrimin e provave që është aty përballë te Prokuroria.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Këtë e tha dëshmitarja [sipas përkthimit] dhe kërkoj t'i referoheni pjesës konkrete ku është thënë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i përgjigjeni pyetjes. Nuk pranohet kundërshtimi.

DËSHMITARJA: [Përkthim] A mund të jeni më i saktë kur thoni që kur mora provat?

Py. Në deklaratën tuaj dhe doli kjo çështje, ju thatë që materiali që ju morët për të shqyrtuar Paketën 3, ju dorëzua nga punonjësja që merren me çështjen dhe menaxhimin e çështjes që është në rreshtin e dytë të Prokurorisë.

Pë. Ia kam dorëzuar unë personit, pra oficeres që merret, punonjëses që merret me menaxhimin dhe e pashë në sistemin

ZyLAB.

Py. Po i kthehemi pikës së parë. Sa për t'ju kujtuar se në transkriptin e 21 tetorit, në faqen 1191, në rreshtin 5, iu bë një pyetje.

"Në një hetim, a ka ndonjë rol konkret për një person që të sigurojë që materiali, i cili mund ta ndihmojë të akuzuarin në ndonjë hetim apo procedim t'i sillet në vëmendje Prokurorit"?

Ju thatë që:

"Nuk kam dijeni".

Pë. Thashë gjithashtu që këtë do të bëja në çdo rast dhe më vonë besoj që e sqarova se tani e kuptova se z. Rees e kishte fjalën për shqyrtimin shfajësues. Mu desh pak kohë sa ta kuptoja se ku donte të dilte me atë pyetje.

Py. Të kalojmë tek rreshti 10:

"Në përvojën tuaj të mëparshme të punës me EULEX-in, e dinit ju që kishte një punonjës që merrej me nxjerrjen e materialeve në çështje si një procedurë normale pune?

"Pë. Nuk isha në dijeni.

"Py. Me qëllim që ta kuptojmë, nuk është pjesë normale e një operacioni të tillë të punës të caktohet një person si punonjës për nxjerrjen e materialit që mund ta ndihmojë Prokurorin, -- të akuzuarin, t'ia çojnë këtë material në vëmendje Prokurorit.

Ju thatë:

"Pë. Jo. Nuk mund ta konfirmoj apo të a mohoj."

Pra, dëshmia juaj në 21 tetor, se ju ishit në dijeni apo kishit arsye ta përdornit një punonjës të tillë.

Pë. Derisa fillova punën në ZPS, nga përvoja ime që kisha më përpara, nuk kisha punuar me ndonjë çështje që shkonte në fazën e gjykimit. Nga përvoja isha deri te faza e bërjes së akuzës. Dhe në këtë rast është rasti i parë që unë përballem me një përvojë të tillë, me një ekip që ka të bëjë me nxjerrjen e materialit.

Py. Pra gjatë 20 viteve të përvojës suaj, të kryerjes së hetimeve, të punës me prokurorë që keni bërë, nuk ka ndodhur asnjëherë që ju të keni pasur kontakt me një person, i cili mund të ketë pasur ndonjë titull tjetër po ka për detyrë, detyrën e punonjësit të nxjerrjes së materialeve?

Pë. Kur isha në EULEX, po, kam pasur kontakt sepse më është dashur të ndihmoj për vendosjen e numrin të faqeve të provave në një nga çështjet. Po kaq, deri këtu kam shkuar.

Py. Në rregull. Të vazhdojmë me transkriptin e 21 tetorit. Në faqen 1196, ju pyetën:

"Pra znj. Pumper jeni duke thënë se, si një hetuese me përvojë për më shumë se 20 vitesh, nuk e keni idenë e rolit që luan një punonjës i nxjerrjes së materialit"?

Dhe përgjigjja juaj është: "Po".

Pë. Po ajo ka qenë përgjigjja ime.

Py. E dimë që keni pasur arsye për të koordinuar punën me

punonjësin apo punonjësen që merret me menaxhimin e provave. S'po ia përmend emrin, që mos ta themi në publik. Por do të doja që të shikonim DHG0231 deri në DHG236, më fal 246. Ta tregojmë në ekran.

Një minutë ju lutem. Ju kërkoj ndjesë, prova ka numrin DHG247.

Py. Siç e shikoni - e shikoni këtë që shfaqet në ekran?

Pë. Mund ta zmadhojmë pak ju lutem?

Py. E vetmja pjesë që dua të shikoni është titulli, është një vend pune i lirë për Menaxhere të Provave dhe të Çështjeve. Aty ke rreshti blu, ku thotë rreshti i raportimit, ku lexon "Rreshti i Raportimit" thotë:

"...i raporton punonjësit ligjor..." për nxjerrjen, për nxjerrjen e materialeve d.m.th.

Kjo tregon se ekziston një post i tillë në ZPS për një person, i cili përgjigjet për nxjerrjen e materialit.

Pë. Nuk i di këto hollësi.

Py. S'ju ka qëlluar asnjëherë të njihni një person të tillë që ka këtë titull në ZPS?

Pë. As nuk e konfirmoj dot, as nuk e mohoj dot.

Py. S'keni pasur ndonjëherë dijeni për një person të tillë?

Pë. Kemi një ekip.

Py. Një ekip që nuk e dini ju, nuk e njihni?

Pë. Nuk thashë që nuk e njoh. Ju më pyetët konkretisht nëse çfarë bëjnë konkretisht ata. Unë e di që ekzistojnë, por nuk e

di se çfarë bëjnë.
Py. Të vazhdojmë me rolin që keni luajtur ju në këtë hetim. Siç thatë, roli juaj është ai i një hetueses, hetueses s përgjithshme dhe informalisht si koordinatore e hetimeve.
Pë. Koordinatore e Operacioneve Hetimore.
Py. Dhe besoj nuk jeni marrë vetëm me këtë çështje?
Pë. E saktë.
Py. Në cilësinë tuaj, me siguri keni ndërmarrë, keni kryer shumë funksione, siç është kjo analizimi i provave?
Pë. E saktë.
Py. Kryerja e shqyrtimit?
Pë. Çfarë shqyrtimi?
Py. E materialit.
Pë. E provave?
Py. Kryerjes së intervistimit të dëshmitarëve?
Pë. E saktë.
Py. Nuk dua të përmend emrat e çështjeve që do të kërkonit të futeshit në seancë private. Por lidhur me çështjet për të cilat ju keni punuar, është e saktë të themi se asnjë nga hetimet publike aktuale apo çështjet nuk lidhen me ndonjë akuzuar serb, e saktë?
Pë. E saktë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj çdolloj pyetjeje që ka të bëjë me hetimet, me brendësinë e hetimeve të ZPS-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.

Vazhdoni.

Z. CADMAN: [Përkthim] Dëshmitarja i është përgjigjur pyetjes. Përgjigjja e saj është në procesverbal. Faleminderit.

Py. Dhe është e saktë të themi se ju keni drejtuar disa pjesë të këtij hetimi edhe pse mbase s'keni qenë në krye të zinxhirit komandues?

Pë. Po, është e saktë.

Py. Siç pamë dje, ju keni bashkërenduar operacionin e kontrollit, pavarësisht se nuk ka dalë ndonjë gjë e prekshme, por ju keni drejtuar dhe operacionin e 25 shtatorit të vitit që shkoi?

Py. Ju thatë se përfshirja e parë tuaja në lidhje me këtë kontrollim, ishte në datën, ndodhi në datën 25 shtator?

Pë. E saktë.

Py. Por është e saktë gjithashtu që të themi që udhëzimet do t’i keni dhënë para disa ditësh sesa të kryhej operacioni?

Pë. Jo shumë ditë përpara, po një apo dy ditë më përpara n.q.s. më kujtohet saktë.

Py. Dhe keni qenë këtu në Hagë kur i keni marrë këto udhëzime?

Pë. Besoj kam qenë në Kosovë kur mora udhëzimet, por këtë mund ta kontrolloni. Nuk jua them dot me 100% siguri.

Py. N.q.s. ka mundësi ta kontrolloni këtë gjatë pushimit të parë do të na ndihmonit të dinim se ku keni qenë kur i morët udhëzimet.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Gjykatësi Kryesues dha urdhër që Dëshmitares mos t'i jepen detyra të kryej kërkime të tjera.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni pyetjes aq sa mbani mend.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Me sa më kujtohet isha në Kosovë.

Py. Pra keni qenë në Kosovë në 22 shtator apo jo?

Pë. Parapëlqej të mos hamendësoj. Nuk jam e sigurt ku isha atë ditë.

Py. Po jua them edhe njëherë, keni qenë në Kosovë në 22, sepse z. Haradinaj në shoqërinë e tre oficerëve të KFOR-it, kur ishte në ballkon ju ka parë në Prishtinë atë ditë, e saktë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtohet të nderuar Gjykatës. Nuk kemi prova që z. Haradinaj e ka parë znj. Pumper në Kosovë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Por i kërkoni asaj që të prezumojë diçka që nuk është provë.

Py. Tani le t'i kthehemi pak fillimit të këtij hetimi. Duke filluar nga data 7, kush kishte përgjegjësi të përgjithshëm në lidhje me hetimin në terren? Ndoshta mund të na duhet që të kalojmë në seancë private shkurtimisht, sepse më duhet që të përmend disa emra.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani? Jemi gati?

Ju lutem të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ *Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar jemi tani nëseancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë private.

Z. Cadman mund të vijoni pyetjen.

Z. CADMAN: [Përkthim] Unë do të qëndroj në seancë private vetëm për këtë pyetje, sa për të përmendur emrat. Pastaj do të kalojmë sërish në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pyetja ime ishte se kush ishte drejtuesi i hetimit në terren pastaj datës 7? Kemi dëgjuar disa emra. Na thatë se keni marrë udhëzime nga znj. Bolici në një fazë të caktuar apo jo?

Pë. Kam marrë përgjigje, kam marrë udhëzime nga znj. Bolici lidhur me shqyrtimin e paketave të sekuestruara. Nuk e di n.q.s. mund të jeni lidhur me kohën për të cilën po flisni.

Py. Mirë atëherë. Në një fazë më të vonë ju keni marrë udhëzime nga znj. Bolici, pastaj keni marrë udhëzime nga z. Whiting?

Pë. Po, gjatë kërkimit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Pë. Më falni po pyesja n.q.s. keni marrë udhëzime prej tij apo që ndaj një zyrë me të?

Py. Ju ndani një zyrë me të, për këtë unë e di, por thjesht d.m.th. do të doja të dija n.q.s. ka qenë i përfshirë në hetime apo jo?

Pë. Unë pra kam lexuar Notat Zyrtare dhe aty referohej përfshirja e tij.

Py. D.m.th. përpara sesa të lexonit Notat Zyrtare, nuk e kishit idenë që ai ishte i përfshirë në hetim?

Pë. Do të thuash në atë kohë?

Py. Po.

Pë. Jo, në atë kohë nuk e kisha idenë.

Py. Atëherë pyetja ime është kjo. Pas datës 7 kur çdo çështje janë sjellë në vëmendjen tuaj, kush kishte përgjegjësi të përgjithshme në terren për këto hetime, duke filluar nga data d.m.th. pas datës 7 shtator?

Pë. Siç e thashë dhe më përpara, unë pyeta në zyrë dhe m'u tha që përgjegjësinë për hetimet në terren nga data 7 e kishte kryeprokurori dhe zëvendësprokurori, përkatësisht z. Smith dhe z. Whiting.

Z. CADMAN: [Përkthim] Një pyetje të fundit dhe pastaj mund të kalojmë në seancë publike të nderuar Gjykatës.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Z. CADMAN: [Përkthim] N.q.s. do më duhet që të përmend sërish emrin e tij do t'i drejtohem atij si nëpunësi X, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem të kthehemi sërish në seancë publike.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi sërish në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni z. Cadman.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pra ndarja e një zyre me nëpunësin X, a është normale që të flasësh, të ndash pikëpamje dhe të flasësh me të?
Pë. Po, flasim.
Py. Të ndani edhe pikëpamje lidhur me çështje të cilat janë të ditës?
Pë. Çfarë do të thuash me këtë, me çështje të përditshme?
Py. E kam fjalën që të flasësh rreth çështjeve të punës?
Pë. Po.
Py. Të flisni rreth çështjeve të zyrës?
Pë. Po.
Py. Dhe si hetues, ju keni punuar në institucione të

ndryshme, keni punuar në vende të ndryshme të botës, kështu që jam i sigurt që ndani edhe histori të ndryshme për luftën?

Pë. Jo me të vërtetë, se z. X nuk është shumë, nuk i ka shumë qejf fjalët.

Py. Duke ndarë një zyrë me të, pavarësisht që ju jeni munduar të jeni e kujdesshme, jam i sigurt që keni dëgjuar diskutime që ai ka pasur me të tjerët?

Pë. Nuk mbaj mend ndonjë gjë specifike por jam e sigurt që po.

Py. Po sa i takon një zyre funksionale, në fakt, komunikimi është një pjesë shumë e rëndësishme e funksionimit të duhur të zyrës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të lutem a mund ta përsërisësh dhe njëherë pyetjen z. Cadman, sepse pati zhurmë në mikrofon.

Z. CADMAN: [Përkthim] E largova mikrofonin. Ju kërkoj ndjesë.

Py. Atëherë pyetja është kjo. Si në një zyrë normale komunikimi normal është shumë i rëndësishëm.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është argumetative pyetja dhe është e përgjithshme, kështu që nuk e kuptojmë se cila është arsyeja kryesore e kësaj pyetjeje. Nuk lidhet me pyetjen kryesore të dëshmitares edhe nuk e dimë se për ku do të dalë Mbrojtja.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ku doni të

dilni me këtë pyetje?

Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar, po mundohem sepse dëshmitarja tha që nuk ka pasur komunikim, nuk ka pasur diskutim dhe thjesht unë po përpiqem të përcaktoj sesi funksionon një zyrë normale dhe sesi është komunikuar, është organizuar puna brenda saj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni i çaktivizuar].

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pyetja është kjo. Çdo zyrë funksionale bazohet në komunikim. Kam përshtypjen që komunikimi është edhe më i rëndësishëm në një zyrë prokurorie. A jeni dakord me mua?

Pë. Jam dakord që komunikimi është një element i çdo zyre.

Py. Dhe kjo në vetvete do të kishte kërkuar takime të rregullta të ekipit apo jo?

Pë. Po.

Py. A keni ndonjë listë të ZPS-së që ka të bëjë me përditësime ose me çështje të rëndësishme?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtoj. Kjo është një pyetje, e cila ka të bëjë me produktin e brendshëm të punës dhe organizimin e zyrës.

Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk po i kërkoj kësaj dëshmitare që të japë ndonjë konfidenciale, por thjesht të na tregojë se çfarë mënyrash, çfarë mjetesh komunikimi kishin ata në zyrë. Pra nuk do të nxirrte asgjë

konfidenciale sa i takon organizimit të zyrës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Vijoni dëshmitare.

DËSHMITARJA: Ju lutem a e përsërisni dhe njëherë pyetjen.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Unë pyeta nëse keni patur ndonjë listë për komunikimin e informacionit lidhur me ngjarje apo aktivitete të rëndësishme?

Pë. Nuk e kuptoj pyetjen. Nuk e kuptoj se çfarë është "Lista" në këtë kuptim.

Py. A keni ndonjë sistem me anë të të cilit bëhet informimi ose le të themi shkëmbimi i informacionit në mënyrë të rregullt lidhur me gjërat që janë të rëndësishme për momentin për zyrën?

Pë. Ne kemi takime të përjavshme, çdo të premte dhe kemi takime ose projekte, me fjalë të tjera kemi ekipe të cilave u janë caktuar projekte specifike. Ato takohen në mënyrë të rregullt, kështu që në përgjithësi më duhet të them që kemi një linjë komunikimi të rregulluar brenda për brenda zyrës.

Py. Pra n.q.s. ndodh diçka e rëndësishme, ngrihet një çështje e rëndësishme do të kishte një forum përmes të cilit i komunikohej kjo çështje gjithë stafit të ZPS-së.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës është spekulative si pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Ne e dimë që ngjarjet që kanë rrethuar këtë çështje, n.q.s. ne do ta pranojmë çështjen e Prokurorisë, paraqisnin një çështje të rëndësishme, shqetësuese për ZPS-në nga data 7 shtator, a nuk është kështu? A nuk është një pyetje e drejtë kjo?

Pë. Po, ishte një çështje shqetësuese, po.

Py. Kur jeni informuar për këtë?

Pë. Besoj se jua kam thënë dhe më parë. Nuk e mbaj mend se kur jam vënë në dijeni të kësaj çështjeje, por u informova për të dhe ishte çështje shqetësuese dhe kemi folur rreth saj.

Py. Sigurisht si nëpunëse e lartë e zyrës rreth datës 7 apo 8 shtator do duhet të jeni informuar rreth saj apo jo?

Pë. Më duhet që ta përsëris. Nuk dua të spekuloj. Sigurisht që jam informuar por nuk e di se kur jam informuar.

Py. Dhe ndarja me një zyre me nëpunësin X në atë kohë –

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk jam e sigurt n.q.s. dëshmitarja tha që në atë kohë kishte të njëjtën zyrë si zyrtari, si nëpunësi X. A mund ta përcaktojmë që dëshmitarja nuk ka qenë fare në zyrë në atë kohë me nëpunësin X?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mundohuni që të jeni sa më specifik të jetë e mundur.

Z. CADMAN: [Përkthim] Ju lutem pyetja është kjo.

Py. A keni ndarë një zyrë me nëpunësin X në atë kohë?

Pë. Sa për të qenë e qartë, po, ne kemi pasur një zyrë. Neve kemi tavolina pune të veçanta në të njëjtën zyrë po nuk e mbaj

mend n.q.s. ai specifikisht gjatë asaj periudhe ka qenë në zyrë apo jo.

Py. A e mbani mend që ai ka udhëtuar në Kosovë më datë 16 dhe sërish më datë 22?

Pë. Jo, nuk e mbaj mend këtë gjë.

Py. Në asnjë kohë ai nuk ju ka thënë juve që kishte udhëtim pune për në Prishtinë gjatë asaj kohe?

Pë. Kjo ka ndodhur një vit më parë. Vërtetë që nuk e mbaj mend.

Py. E di që ju thatë që ai nuk është se i kishte shumë qejf fjalët, por juve besoj se duhet të keni qenë të informuar për historikun e tij profesional deri në një fare mase të caktuar?

Pë. Deri në një farë mase, po.

Py. [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po themtjetër gjë. Ju lutem mos jepni informacione të tjera identifikuese për këtë person.

Z. CADMAN: [Përkthim] Mirë në rregull atëherë le të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Z. Cadman mund të vijoni.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Dua të kaloj te struktura organizative, tek organigrama si dhe tek rregullat e brendshme të zyrës. Pra ZPS-ja është krijuar që prej vitit 2016, ndërkohë që juve keni pjesë e kësaj zyre që nga fillimi?

Pë. Po.

Py. ZPS-ja ka trashëguar mandatin nga TFHS-ja?

Pë. Po.

Py. Ndërkohë që nuk mendoj dhe nuk e imagjinoj që juve të jeni të ndërgjegjshëm, të dini informacione specifike, megjithatë është e dukshme që buxheti ka qenë i konsiderueshëm duke marrë parasysh madhësinë e operacioneve apo jo?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj të nderuar Gjykatës. Është spekulative.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është me rëndësi.

Z. CADMAN: [Përkthim] Çështja kryesore është që bëhet fjalë për një operacion relativisht të madh. A jeni në dijeni të kësaj gjëje?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Sërish kundërshtoj. N.q.s. thotë që është relativisht e madhe me çfarë e krahason këtë gjë?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Ju mund t'i përgjigjeni pyetjes.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Nuk mund të them që është operacion i madh, mesatar apo i vogël.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Mirë atëherë, nuk do të vazhdojmë me pyetje të tjera sa i takon përmasës së operacionit, por besoj që jeni dakord që një operacion i kësaj natyre kërkon një lloj niveli organizimi, apo jo?

Pë. E konfirmoj pozitivisht.

Py. Dhe po ashtu jeni dakord me faktin që një institucion i tillë duhet që të regjistrojë aktivitetet kryesore që kanë të bëjnë me hetimet penale.

Pë. Jam dakord.

Py. Dhe n.q.s. bëhen pyetje duhet që të ketë çdo gjë të regjistruar sa i takon asaj çfarë ndodh në një rast të caktuar.

Pë. A mund të më shpjegoni se çfarë doni të thoni kur thoni "çfarë ndodh me një çështje"?

Py. Jeni dakord që në një zyrë Prokurorie duhet që të keni procesverbal dokumentacion regjistrimi të të gjitha veprimeve, masave të cilat merren në kuadër të një çështjeje të caktuar dhe n.q.s. ngrihet ndonjë shqetësim i caktuar në një fazë të caktuar?

Pë. Nuk e di se ne çfarë niveli regjistrimi i të dhënash juve i referoheni, megjithatë informacioni merret përpunohet dërgohet dhe gjithashtu regjistrohet më pas, pasi i kalon të

gjitha fazat e mundshme në prova. Megjithatë n.q.s. e ke fjalën për komunikimin e brendshëm mendoj se si individ d.m.th. bëhet komunikimi nga organizata për në organizatë. D.m.th. kjo varet nga lidershipi, nga udhëheqja e institucionit.

Py. Ju e keni thënë në fakt, e keni thënë më shumë sesa njëherë se udhëzimet ju janë dhënë juve me gojë nga znj. Bolici. A është e saktë kjo?

Pë. Në fakt unë mendova për këtë dhe besoj që kam edhe komunikim me email, nuk e di n.q.s. e kam thënë këtë gjë më përpara apo jo.

Py. Mund t'i kthehemi kësaj çështjeje pas pushimit besoj. Megjithatë ajo çfarë keni thënë ju është që juve ju është dhënë, ju janë dhënë udhëzime me gojë dhe që nuk janë bërë shënime të asaj kohe si rezultat i këtyre udhëzimeve, të dhënave?

Pë. Jo, nuk kam bërë shënime në atë kohë të udhëzimeve që kam marrë.

Py. Por tani po na thua që keni edhe korrespondencë me email me znj. Bolici, që ju ka udhëzuar të merreni me këtë çështje apo jo?

Pë. Po, ka pasur komunikime me email. E mbaj mend tani. Ju kërkoj ndjesë. Ka ndodhur një vit më përpara. Po mundohem që të kujtoj sa të mundem. Por ka patur një kombinim, d.m.th. komunikim me gojë dhe komunikim me email.

Py. Udhëzimet me shkrim ju kanë ardhur vetëm nga znj. Bolici apo ju kanë ardhur dhe nga anëtarë të tjerë të organizatës tuaj?

Pë. Mbaj mend të paktën një komunikim tjetër me email. Nuk është udhëzim, por është një email ku më jepet ca informacion për t'u shqyrtuar prej meje.

Py. Kush ja u dha këtë udhëzim?

Pë. Duhet ta them emrin?

Py. Ju jam mirënjohës që ju drejtuat Gjykatësit në vend që t'i ktheheshit, të shikonit znj. Bolici?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky komenti nuk ishte i nevojshëm. Ju lutem bëni vetëm pyetjen.

Z. CADMAN: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private në mënyrë që të mund ta bëj këtë pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi sërish në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të vazhdoni z. Cadman.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Cila ishte natyra e këtyre udhëzimeve?

Pë. Kam marrë një email ku më thuheshin dosjet ku ishin, ku gjendeshin komunikime të tilla, dhe mbi bazën e të cilave më duhej që të shkruaja paragrafët besoj 32 deri 34 të deklaratës time. Kjo dosje ishte e konsoliduar dhe ishte më e thjeshtë për mua për të shqyrtuar atë. Nuk kishte udhëzim lidhur me të.

Py. Tani le të qëndrojmë pak te procedurat e brendshme. Si një argument i përgjithshëm, a e pranoni që një zyrë prokurorie e tillë si zyra juaj mund të funksionojë siç duhet vetëm n.q.s. ka protokolle dhe udhëzime të brendshme të qarta lidhur me çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e zyrës dhe me realizimin e hetimeve.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj të nderuar Gjykatës, është argumentative.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Kjo është një pyetje e përgjithshme dhe mund të konfirmoj se nga perspektiva ime ne kemi një linjë të qartë funksionale dhe organizim të qartë në

zyrë.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pyetja nuk ka të bëjë me komunikimin se për këtë gjë ju dëgjuam, por pyetja ka të bëjë me udhëzimet dhe protokollet e brendshme n.q.s. ato ekzistojnë në zyrë për çështje të ndryshme që ka të bëjë me strukturën e brendshme të zyrës apo me realizimin, kryerjen e hetimeve.

Pë. Lidhur me strukturën e brendshme, po ka një strukturë të brendshme në zyrë. Lidhur me udhëzimet për hetimet mendoj se e kam thënë dhe më parë që nuk është se mbaj mend të kem parë ndonjë gjë të shkruar në këtë drejtim.

Py. Ju nuk keni parë asnjë udhëzim me shkrim lidhur me realizimin e hetimeve apo me aspektet e tjera të punës tuaj përveç pjesës të organizimit të institucionit tuaj.

Pë. Juve po i referoheni një teme goxha të gjerë, ne kemi për shembull udhëzime për shembull n.q.s. na duhet që të udhëtojmë, duhet që të bëhen plotësimet e dokumentacionit përkatës, duhet që të miratohen ato ose nëse për shembull në momentin kur intervistojmë personat kemi një proces të caktuar se si shkojmë, si takohemi me njerëzit, kemi diskutime me strukturat drejtuese. Kur kthehemi pra raportojmë për rezultatin. Sa i takon parashtrimit të provave ka një procedurë të caktuar, kështu që në përgjithësi unë mendoj që [nuk] ka ndonjë problem shqetësues, por nuk e di n.q.s. keni ndonjë gjë specifike për të më pyetur.

Py. Unë po e bëj këtë pyetje dhe sërish ndoshta do të duhet që të t’i kthehemi kësaj pike pak më pas, por juve thatë përpara që nuk ishit në dijeni të ekzistencës të protokolleve apo të udhëzimeve të zyrës.

Pë. N.q.s. e kuptoj siç duhet dhe ju kërkoj ndjesë n.q.s. ju kam keqkuptuar, juve po i referoheshit udhëzimeve për sa i takon realizimit ose kryerjes të hetimeve. Ne nuk kemi udhëzime për kryerjen e hetimeve. Ne kemi udhëzime të tilla si për shembull udhëzime operative sesi ta realizojmë këtë.

Py. A keni udhëzime lidhur me kontrollin, operacionet e kontrollit?

Pë. Po, ne kemi udhëzime që lidhen me procedurat e kontrollit dhe të sekuestrimit.

Py. Keni udhëzime për çështje të brendshme të sigurisë?

Pë. Ne kemi udhëzime lidhur me çështje të brendshme të sigurisë.

Py. Në çfarë faze jeni vënë ju në dijeni për këto udhëzime, kur keni filluar punë për herë të parë për zyrën?

Pë. E keni fjalën për udhëzimet për sigurinë?

Py. Për këto udhëzime të cilat juve na përmendët. Kur jeni vënë në dijeni për herë të parë për to?

Pë. Për udhëzimet e sigurisë unë jam informuar menjëherë pasi jam marrë në punë. Është pjesë e paketës së prezantimit në vendin e punës. Po ashtu ne diskutuar edhe për udhëzimet për kontrollin dhe sekuestrimin. Kam qenë gjithashtu edhe

përfshirë në zhvillimin duke ditur për çfarë folëm tjetër për kontrollin dhe sekuestrimin, kërkimin e sekuestrimin, kam qenë pjesë e hartimit të tyre, zhvillimit të tyre.

Py. Pra ju keni qenë pjesë e hartimit për kontrollin dhe sekuestrimin, jo për rregullat, udhëzimet?

Pë. Po, për udhëzimet.

Py. Tani dua që t'i kthehemi pas asaj që ndodhi menjëherë pas datës 7 shtator. Duke e pranuar që sipas jush, apo sipas ZPS-së, kjo ishte një rrjedhje e konsiderueshme e të dhënave. Prokurori a organizoi një takim me gjithë stafin e tij për t'ju informuar se çfarë kishte ndodhur?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar, kjo pyetje është bërë dhe ka marrë përgjigje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Ju mund t'i përgjigjeni kësaj pyetje.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Do më duhet që ta sqaroj. Në një pikë është bërë një takim nga Kryeprokurori, po Prokurori i Specializuar ka bërë njoftim për këtë, po.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Dhe kur ka ndodhur kjo?

Pë. Nuk e mbaj mend datën.

Py. Pra u bë një takim në nivel zyre kur ju u informuat për këtë rrjedhje të të dhënave?

Pë. Jo, atë nuk e mbaj mend. Nuk e mbaj mend n.q.s. ka pasur ndonjë njoftim në zyrë ose ka pasur një shkelje të kësaj

natyre, por e mbaj mend që ka pasur një njoftim pas ca kohe, sa i takon rrjedhjes së të dhënave.

Py. A bëhej fjalë për të gjithë zyrën që u informua për këtë apo bëhej fjalë për një skuadër të vogël të informuar mbi këtë gjë.

Pë. Për të gjithë zyrën.

Py. Çfarë hapash të tjerë pasues janë marrë pastaj këtij njoftimi? Ose ta bëj pak më thjesht pyetjen. A janë marrë masa të tjera pasuese brendapërbrenda institucionit si rezultat i rrjedhjes së këtyre të dhënave?

Pë. Siç e thashë, nuk e mbaj mend që Prokurori i Specializuar të ketë njoftuar rrjedhën e të dhënave, por çfarë mbaj mend unë është që u bë një ndryshim, një amendim i procedurës dhe protokolleve të sigurisë menjëherë pas ndodhjes së këtij incidenti.

Py. Ne kemi folur gjithashtu edhe për madhësinë e zyrës. Ju nuk jeni dakord me mua kur unë them që është një zyrë e madhe, por pyetja që kam për ju është kjo. Në një pikë të caktuar nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2020, ca staf i ZPS-së ose iu mbaroi mandati ose pushuan së punuari me ZPS-në. A jeni në dijeni të kësaj gjëje?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kjo pyetje është bërë më përpara dhe ka marrë përgjigje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo ka qenë pjesë e pyetjeve të Mbrojtësit tjetër dhe besoj që përgjigjja

ka qenë që ajo ishte në dijeni të njerëzve që janë larguar dhe gjithashtu dha edhe kohën dhe datën se kur ka ndodhur kjo gjë.

Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar, n.q.s. mund të këshillohem një moment lidhur me këtë çështje?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mundesh.

[Mbrojtja këshillohet]

Z. CADMAN: [Përkthim] Ndoshta do të duhet t'i kthehemi asaj pike, por për momentin dua të them këtë.

Py. Ju thatë se udhëzimet që keni marrë nuk kanë qenë vetëm gojarisht të dhëna, por edhe me shkrim nëpërmjet emailit. Kjo është dëshmia juaj e sotme?

Pë. E saktë.

Py. Por po të shikojmë transkriptin e datës 20 tetor, faqen 1066, ju aty thoni të kundërtën. Thoni se nuk ka pasur udhëzime me shkrim, se udhëzimet që i keni marrë nga znj. Bolici janë dhënë gojarisht.

Py. Nuk më kujtohet të kem thënë se nuk ka pasur fare udhëzime me shkrim. Besoj se kam thënë ka pasur udhëzime gojore. Dua të konfirmoj se më kujtohet të kem marrë edhe udhëzime me shkrim, disa emaile dhe kjo është në procesverbal të dëshmisë time.

Py. Të shkojmë tek faqja 1066 e transkriptit, rreshti numër 8.

Aty thoni, pyetja që ju bë është:

"A i dërguat email personit për të konfirmuar

jozyrtarisht se çfarë u është kërkuar të bëni?

Dhe ju u përgjigjët:

"Nuk më kujtohet.

Pyetja ishte më pas:

"A është kjo mënyra e rregullt e veprimit të ZPS-së?

Ju u përgjigjët:

"Po.

"A është mënyrë e rregullt e veprimit që të merrni detyrën për të marrë veprime gojarisht pa ndonjë urdhër me shkrim?

Dhe ju u përgjigjët:

"Po, ashtu është".

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për hir të procesverbalit Mbrojtësi i referohet faqes 1068 të transkriptit dhe aty përgjigjja e dëshmitares vazhdon. Unë e kam parasysh rreshtat 5 deri në 13 të asaj faqeje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për momentin kundërshtimi juaj refuzohet.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Tani do t'i kthehem rolit tuaj gjatë një hetimi. Ajo që thatë ju është se morët udhëzime për të kryer shqyrtimin e materialit, e tre paketave dhe të nxirrni një vendim. Të përcaktoni n.q.s. ai material ishte i përfshirë në bazën e të dhënave tuaja. Këtë ua kërkuan të bënit apo jo?

Pë. Jo vetëm këtë. Sikurse e shikoni nga deklarata ime, ka

edhe çështje të tjera për të cilat kam raportuar. Jo, jo vetëm për këtë që e përmendni ju.

Py. Do t'i kthehemi asaj, por kryesisht prej jush u kërkua që të bëni shqyrtim të tre paketave. Dhe kur ju pyetën n.q.s. keni bërë analizë shtesë, ju u përgjigjët që: Nuk më dhanë udhëzime për këtë.

Pë. Nuk kam kryer asnjë analizë tjetër përveç asaj që më kanë dhënë për detyrë. Kjo është deklarata ime.

Py. Dhe nga 25 shtatori, dua të shoh se çfarë ndodhi pas këtij momenti kohor në kuptim të hetimit. D.m.th. ju ishit në dijeni të asaj që dukshëm ishte nxjerrje, shkelje e sigurisë dhe si një hetuese me përvojë a nuk pajtoheni me mua se për çdo hetim duhet të merren parasysh të gjitha faktet, të ndiqen të gjitha udhëzimet dhe provat për të parë se çfarë duhet përcaktuar.

Pë. Kur thoni se duhet të ndiqen të gjitha burimet e informacionit, duhet të merren parasysh dhe këtë po e them hipotetikisht të gjitha, i gjithë operacioni, duhet të bëhet, t'i jepet prioritet aspekteve të ndryshme të operacionit. Ka faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që luajnë një rol gjatë përcaktimit të kësaj. Ka çështje të personelit dhe të sigurisë që duhet të merren parasysh dhe cilat mund të ndikojnë në ecurinë e hetimit.

Py. Ju thatë se hipotetikisht ju sigurisht do të urdhëronit survejimin, por se kjo nuk ka qenë detyra juaj?

Pë. Unë mendoj se thashë se do ta kisha marrë këtë si opsion parasysh.
Py. Pas datës 25 ju nuk keni urdhëruar mbikëqyrjen e zyrave?
Pë. Nuk jam përfshirë në procesin e vendimmarrjes.
Py. Dhe krahas kërkesës që është bërë, nuk është bërë asnjë diskutim për këtë gjë.
ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kam kundërshtim të nderuar Gjykatës.
Z. CADMAN: [Përkthim] Do ta parafrazoj pyetjen.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni këtë pyetje.
Z. CADMAN: [Përkthim]
Py. A jeni në dijeni të ndonjë kërkese të organizatës apo të të pandehurve për të vendosur zyrat nën mbikëqyrje?
Pë. Jo.
Py. Gjithashtu na konfirmuat se në kuadër të përgjegjësive tuaja, është edhe intervistimi i dëshmitarëve dhe të dyshuarve, a është kjo e saktë?
Pë. Po, unë gjithashtu intervistoj të dyshuar dhe dëshmitarë.
Py. Por ju nuk intervistuat as z. Haradinaj as z. Gucati?
Pë. Nuk mora këtë detyrë.
Py. Keni të drejtë. Dhe nuk keni intervistuar asnjë person në OVL UÇK?
Pë. Nuk jam përfshirë në këtë. Është e saktë.
Py. Ju nuk keni intervistuar asnjë person në ndërtesën e OVL

UÇK-së?
Pë. Jo.
Py. Dhe me sa dini ju, askush nga ekipi juaj nuk e ka bërë këtë?
Pë. Nuk e di se çfarë kanë bërë ata sepse nuk kam qenë pjesë e atij hetimi.
Py. Nga data 25 shtator e më pas ju nuk keni qenë në dijeni për ndonjë veprim që është marrë si pjesë e këtij hetimi.
Pë. Kam qenë në dijeni në kuptim të faktit se i kam shqyrtuar paketat dhe kam bërë Nota Zyrtare, por nga aspekti operativ kur kanë ndodhur gjërat unë për këtë nuk kam pasur dijeni dhe nuk kam qenë e përfshirë.
Py. D.m.th. ju nuk keni bërë intervistimin e gazetarëve që kanë qenë të pranishëm në press konferencat?
Pë. Kam qenë e përfshirë në intervistimin e tre gazetarëve.
Py. Ju nuk keni pasur arsye të merrni në pyetje z. Azem -- mbiemrin nuk e dëgjoi përkthyesi?
Pë. Nuk më kujtohen emrat.
Py. Përballë ndërtesës ka disa dyqane, biznese që kanë kamera sigurie të drejtuara nga ndërtesa ku ndodhen zyrat e OVL UÇK-së. Ju nuk e keni parë të arsyeshme që të intervistoni ata për të siguruar këto incizime të video-kamerave të sigurisë?
Pë. Mendoni unë personalisht? Unë nuk u përfshiva në atë hetim.
Py. Me sa dini ju kush prej hetuesve të tjerë kreu intervista

me ata persona?

Pë. Nuk e di këtë.

Py. Dhe gjithashtu kemi dëgjuar dhe ju e keni konfirmuar se nuk keni pasur kontakt të drejtpërdrejtë me pjesëtarë të policisë së Kosovës si pjesë e hetimit.

Pë. Duhet të bëjmë një dallim midis dy gjërave, përfshirja ime në kontrollin. Aty ka pasur prani të policisë të Kosovës. Ata kanë qenë pjesë e ekipit në lidhje me atë që ju e quani hapa hetimorë, hetimin e nxjerrjes së paketave. A e keni për këtë fjalën?

Py. Pyetja ime është, përveç policisë së Kosovës që ka qenë jashtë ndërtesës, ju nuk keni pasur kontakt me ta në kuadër të hetimit apo të rolit tuaj në këtë hetim?

Pë. Mendoni roli im në kontrollin e kryer?

Py. Unë po flas përgjithësisht si pjesë e detyrave që kishit nga data 25 e më tej.

Pë. Nuk u përfshiva në hetime përveçse kam biseduar me gazetarët. Unë nuk kam biseduar me asnjë pjesëtar të policisë apo punonjës të policisë të Kosovës.

Py. Po kush e kishte këtë përgjegjësi atëherë?

Pë. Sikurse kam thënë edhe më herët, përgjegjësia e përgjithshme e dhënies së informacionit ishte e Prokurorit të Specializuar dhe zëvendësit të tij. Ata u jepnin detyra punonjësve të tjerë për kryerjen e hapave hetimorë.

Py. Përpara datës 25, a keni, a është kërkuar prej jush që të

krijoni një plan pune për hetimin?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kjo është pyetur dhe përgjigjur më herët.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, kundërshtimi refuzohet.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Nuk kam pasur kurrfarë përfshirje në hetimin përpara kësaj.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. A jeni duke thënë që nuk jeni përfshirë në hetimin e asaj se si rrodhi informacioni, materiali?

Pë. Nuk jam përfshirë në këtë hetim, me përjashtim të kontrollit kur kemi kërkuar material. Të jemi të saktë në këtë rast.

Py. Kur diskutojmë kontrollin e kryer të datës 25 shtator, i gjithë kontrolli u incizua me video?

Pë. Po.

Py. Dhe me sa dini ju incizim i tillë nuk ekziston për operacionet e kryera më datën 8, 17 dhe 22?

Pë. Nuk kam dijeni.

Py. Por nuk keni pyetur për këtë?

Pë. Sikurse thashë unë nuk kam bërë pyetje. Mua më janë dhënë detyra konkrete për të kryer dhe këtë e kam bërë.

Py. Gjatë kryerjes së kësaj detyre nuk kam qenë në dijeni se janë bërë incizime të tilla.

Py. D.m.th. nuk keni qenë në dijeni. Pyetja ime ishte a keni

pyetur atëherë mbas datës 25 shtator për një kopje të video-incizimit të operacionit të datës 8, 17, dhe 22?
Pë. Sikurse thashë, unë nuk kam qenë në dijeni. N.q.s. ka pasur video-incizime dhe nuk kam pyetur për një gjë të tillë.
Py. D.m.th. nuk i keni kërkuar ato video-incizime, nuk keni pyetur për to?
Py. T'i kthehemi asaj çka u kërkua prej jush të bënit. Pra të shqyrtoni atë që juve iu paraqit si tre paketat dhe ju konfirmua se nuk jeni përfshirë në sekuestrimin e atij materiali në datë 8, 17, dhe 22, a është kjo e saktë?
Pë. E saktë.
Py. Dhe siç thatë në secilin prej këtyre tre paketave -- dhe mund t'i kthehemi këtyre pas pushimit -- i vetmi dokument që ju dha juve ishin këto tre formularët e fletë-dorëzimit që i patë me z. Rees gjatë kundërpyetjeve të tij.
Pë. Jo vetëm ato tre fletë-dorëzime.
Py. Ju thatë se ato dokumente që i patë ishin faqet e para të fletë-dorëzimeve për secilën prej paketave që morët?
Pë. Po, e saktë.
Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës do t'i kthehem kësaj pike edhe njëherë pas pushimit të drekës. Desha të kontrolloja dhe njëherë referencat.
[Mbrojtja këshillohet]
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees, sigurisht e kishit parasysh mbas këtij pushimi që kemi tani,

jo mbas pushimit të drekës.

Z. CADMAN: [Përkthim] Po, pikërisht ashtu. Kam edhe dy pyetje shtesë për këtë dëshmitare mbi këtë temë dhe sigurisht që nuk do të më duhet kohë deri mbas pushimit të drekës për të gjetur referencat. Më duhen vetëm referencat për faqet e transkriptit në lidhje me dëshminë për pres konferencat dhe për fletë-dorëzimet. Mund ta bëjmë pushimin tani për sa i përket Mbrojtjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë pushim tani dhe do të vazhdojmë në 11.20 dhe prej atij momenti do të vazhdojmë deri në pushim të drekës.

Ju faleminderit znj. Pumper.

[Dëshmitarja përfundon dëshminë]

--- Pauza fillon në orën 10.50

--- Seanca rifillon në orën 11.20

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z. Cadman, por na duhet dëshmitari.

Ju lutem silleni Dëshmitaren.

[Dëshmitarja vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman do të vazhdojë me pyetjet.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për procesverbalin, menaxhuesja e lëndës dhe e provave nuk është e pranishme për momentin por do të vijë së shpejti.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

Z. Cadman.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. T'i kthehemi pikës që e trajtuam pak para pushimit, në faqen 33, rreshti 23 e seancës së sotme:

"Kjo ishte pjesë e kundërpyetjeve z. Cadman. Mendoj që përgjigjja ishte se ajo e dinte që njerëzit po largoheshin dhe mbajti shënim kohën e kësaj".

Unë dua ta korrigjoj këtë dhe kjo është në transkriptin e datës 21 tetor në faqe 1249, rreshtat 16 e më pas. Aty thuhet:

"A mund të konfirmoni se në periudhën midis 22 shtatorit dhe dhjetorit 2020, rreth 25 anëtarë të stafit duke përfshirë udhëheqës të ekipeve, lanë punën?

Përgjigjja ishte:

"Pë. Jo, nuk mund ta konfirmoj këtë.

"Py. Pa dhënë ndonjë shifër, a mund të konfirmoni se keni pasur dijeni për largimin e ndonjë anëtari të stafit të ZPS-së në atë periudhë"?

Dhe znj. Bolici kundërshtoi. Kjo është në faqen 1250, rreshtat 14 e më tej. Pastaj z. Rees vazhdon:

"Po, pyetja e fundit është përgjigjur: A e dini n.q.s. në atë kohë ndonjë anëtar i stafit të ZPS-së është larguar nga puna"?

PËRKTHYESJA: Përkthyesit kërkojnë që të flitet më ngadalë.

Z. CADMAN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë të nderuar Gjykatës,

do ta përsëris pyetjen.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. "A e dini n.q.s. kishte ndonjë anëtar të stafit të ZPS-së, i cili i përfundoi kontrata në periudhën midis shtatorit dhe dhjetorit të vitit 2020?

"Pë. Nuk më kujtohet n.q.s. dikush konkretisht u largua në atë kohë".

Z. CADMAN: [Përkthim] Kjo ishte përgjigjja juaj. Do t'ju korrigjoj i nderuar Gjykatës se ajo, d.m.th. Dëshmitarja i dha përgjigje kësaj pyetje.

Py. Tani do tu kthehem një numër pyetjesh, çështjesh që i diskutuam pak më herët.

Sot ju thatë:

"E gjithë përvoja ime përpara se të filloj punë me ZPS-në, nuk ka përfshirë ndonjë çështje që ka kaluar në fazën e gjykimit. Përvoja ime është vetëm në pjesën e hetimeve deri në daljen e një aktakuze dhe pastaj kaloj në një çështje tjetër".

Këtë e keni thënë sot.

N.q.s. e shikojmë transkriptin e datës 20 tetor 2021, z. Rees ju pyet aty n.q.s. keni dhënë dëshmi në ndonjë gjykim tjetër. Ju thatë që po keni dhënë. D.m.th. përgjigjja juaj nuk është e saktë. Ju keni qenë Dëshmitare në një proces gjyqësor të mëparshëm. Atëherë cila është përgjigjja juaj?

Pë. Nëse më lejoni, ajo që thashë sot ka të bëjë me pjesën e punës time si hetuese, duke bërë detyrën e hetueses. Por në

përgjithësi kam dhënë dëshmi si dëshmitare në një gjykim të mëparshëm.

Py. Ju gjithashtu thatë se nuk jeni në dijeni të, nuk jeni në dijeni për detyrimet e nxjerrjes së materialeve për shkak të faktit se nuk jeni përfshirë në ndonjë fazë gjykimi më parë. Por ju me siguri e dini që këto detyrime të nxjerrjes së materialeve vlejnë që nga dita e parë e punës apo jo?

Pë. Ajo që thashë për mendimin tim është se n.q.s. has në dëshmi shfajësuese, atëherë këtë ia raportoj Prokurorit menjëherë. Kjo është detyra ime si hetuese në një çështje. Mendoj gjithashtu se thashë më herët ne në këtë zyrë kemi një ekip që merret me nxjerrjen e materialeve dhe se unë jam përfshirë në shqyrtimin e materialit shfajësues.

Py. D.m.th. ju keni dijeni se ka anëtarë të ekipit tuaj që merren me çështjen e nxjerrjes së materialeve?

Pë. Mendoj se këtë e thashë edhe kur më pyetët më herët se bëjmë shqyrtim të materialeve shfajësuese.

Z. CADMAN: [Përkthim] Tani dua të shikojmë në ekran transkriptin e asaj që mendoj se është konferenca e parë për shtyp me numër 081344-01-TR-ET.

Py. Në faqen 2, rreshtat 15 deri në 17, aty shikoni si z. Haradinaj i kritikon anëtarët e parlamentit dhe përmend atë që ai e çmon si gjykatë mono-etnike.

Pë. Nuk kam numrin e rreshtave përpara në ekran.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si duket nuk

ka numra të rreshtave në provën materiale.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për hir të procesverbalit është prova P1 që është pranuar si e tillë në këtë proces.

Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një minutë ju lutem që të kontrolloj dhe njëherë numrat e referencës. Mesa duket referenca e dokumentit që është i shënuar si Nxjerrja 2, duhet ta kontrolloj dhe njëherë atë referencë sepse mund të ndodhë që ajo që po përdor unë tani është nxjerrë si provë, mirëpo nuk e ka numrin e njëjtë të referencës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A do të kaloni në një temë tjetër tani?

Z. CADMAN: [Përkthim] Dua të kontrolloj edhe njëherë numrat e referencave se ka disa të tilla që duhet të kontrolloj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani ju kuptova. Në rregull.

[Mbrojtja këshillohet]

Z. CADMAN: [Përkthim] Do të kaloj në një temë tjetër ndërkohë që po i kontrollojmë numrat e referencave që i përmenda.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Sot në mëngjes përmendët një takim që u zhvillua në një zyrë të madhe pas datës 7. A mund të na thoni se kur u zhvillua një takim i tillë afërsisht?

Pë. E kisha fjalën për një takim disa muaj mbas datës 7.
Py. Një muaj?
Pë. Disa muaj, shumës. Disa muaj pas datës 7.
Py. Pra pas konferencës së shtypit të datës 7 shtator. Mbas këtij nuk ka pasur një takim në zyrë?
Pë. Mbaj mend një që u zhvillua disa muaj pas asaj dite, ku Prokurori foli me një ekip, me të gjithë ekipin.
Py. Pra ju nuk dini nëse është zhvilluar ndonjë takim mbas datës 7?
Pë. Ka kaluar një vit. Nuk e mbaj mend.
Py. Nuk mbani mend që është zhvilluar ndonjë takim mbas konferencës së dytë të shtypit, mbas datës 17?
Pë. Nuk mbaj mend ndonjë takim.
Py. Asnjë takim nuk është zhvilluar mbas datës 22 shtator?
Pë. Nuk po them se nuk është zhvilluar ndonjë takim, por them se ka kaluar një vit dhe nuk mund ta konfirmoj apo ta mohoj.
Py. Ju nuk keni qenë pjesë në këtë takim se një takim është zhvilluar?
Pë. Nuk e di nëse është anglishtja që s'po e them qartë, por po them nuk e mbaj mend që të jetë zhvilluar një takim i tillë.
Py. Kur u dhanë udhëzime të bënit punën që duhet të bëni nuk u bë ndonjë raportim mbas datës 25 lidhur me ngjarjet që ishin zhvilluar?
Pë. A mundet - kur thoni "raportim" çfarë keni parasysh?

Py. Raportim lidhur me atë që kish ndodhur sepse ka një sugjerim që ka ndodhur një shkelje e rëndë e sigurisë lidhur me të dhënat nga Zyra e Prokurorisë dhe ju nuk jeni informuar as mbas një muaji për këtë gjë?

Pë. Siç thashë mbas datës 7 të nxjerrjes së parë - nuk e mbaj mend egzaktësisht datën. Thjesht nuk e mbaj mend, nuk thashë që nuk u bë apo nuk u bë. Po u zhvillua një takim ku gjithë zyra u informua për këtë çështje, këtë po them.

Py. Por me siguri do të duhet të të kujtohet nëse u zhvillua një takim lidhur me një ngjarje katastrofike e brendshme e zyrës apo jo?

Pë. Mund të them vetëm se nuk e mbaj mend.

Py. Nuk mbani mend asnjë takim edhe mbas konferencës së dytë?

Pë. Iu përgjigja pyetjes.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Deri tani është përgjigjur dhjetë herë, kështu që unë do të sugjeroja të kalonim në linjën tjetër të pyetjeve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë e hodha poshtë kundërshtimin. Mund të përgjigjeni për takimin e dytë.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Është e njëjta përgjigje. Nuk e mbaj mend, ka kaluar shumë kohë.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Edhe mbas konferencës së tretë të 22-shit?

Pë. Është e saktë.

Py. Edhe pasi bëtë kontrollimin në datën 25 nuk u zhvillua

ndonjë takim rreth asaj kohe, që trajtonte këto çështje brenda zyrës tuaj?

Pë. Duhet të them ne kemi çdo të premte një takim. Unë po them vetëm që nuk mbaj mend që atë takim javor të jetë përmendur diçka e tillë, ndryshe do të supozoja, do të merrja me mend po të thosha.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ka thënë qartë. Vazhdojmë më tej.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Edhe një pyetje të fundit për këtë pikë. Pra tek ato raportimet javore apo takimet javore si t'i quajmë kryesohen nga Prokurori i Specializuar?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtojmë për relevancën, rëndësinë e detajeve të takimit të procedurave të brendshme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Ka një lidhje periferike, po ju thatë vetëm një pyetje dhe po e lejoj.

DËSHMITARJA: [Përkthim] Në përgjithësi Prokurori i Specializuar nuk merr pjesë në këto takime.

Pë. Më falni, duhet të sqaroj. Nuk e di nëse ishe i pranishëm. Doja të thoja nuk flet, mund të ketë qenë i pranishëm.

Py. Nga data 7 deri në datën 25, duhet të keni zhvilluar tre takime të premteve si ekip?

Pë. N.q.s. nuk janë anuluar, po. Besoj që po.

Py. Ju kujtohet nëse është anuluar ndonjë prej tyre?
Pë. Nuk mbaj mend. Ka kaluar një vit.
Py. Ato procesverbalet e takimeve shpërndahen apo mbahen vetëm prezantime me gojë, bëhen vetëm paraqitje me gojë?
Pë. Bëhen me gojë dhe nuk e di nëse dikush mban procesverbale.
Py. Pra doni të thoni që ju nuk keni marrë procesverbalin e këtyre takimeve?
Pë. Jo, nuk e kam marrë.
Py. Thatë që morët dijeni për konferencën e parë të shtypit mbas datës 7. Ju kujtohet se kur e keni mësuar këtë?
Pë. Nuk e mbaj mend.
Py. Mbas një dite?
Pë. Siç thashë nuk mund ta them me siguri, mbas një dite apo mbas dy ditësh.
Py. Ju kujtohet sesi e mësuat?
Pë. Jo nuk e mbaj mend.
Py. Më herët folët për masat e sigurisë që u morën si rezultat i asaj që kaloi, mbas asaj që ndodhi, mbas tre konferencave të shtypit, çfarë masash sigurie keni marrë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj për pyetjet lidhur me protokollet e brendshme të sigurisë së zyrës.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykues do të dijë se ku shkon - ku doni të dilni me këto pyetje? Nuk

shohim që të ketë shumë rëndësi – lidhet me masat e brendshme të punës. Duhet të jeni shumë i kujdesshëm dhe ta paraqisni çështjen si duhet që ta dimë dhe ne se ku doni të dilni dhe të marrim vendim përkatësisht.

Z. CADMAN: [Përkthim] Ajo që thashë unë lidhur me ato që tha dëshmitarja më herët është se janë marrë masa sigurie si rezultat i kësaj shkeljeje që ndodhi. Thjesht dua të gjej se cilat masa, çfarë masash janë marrë dhe kur janë marrë këto masa.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk jeni të kënaqur me përshkrimin që janë marrë masa sigurie. Nuk lidhet kjo pak me pyetjet që po bëni? Është si hetim dhe ju se keni të drejtë këtë?

Nuk keni nevojë t’i përgjigjeni pyetjes.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Pra duke mos i thënë çfarë masash janë marrë, a mund t’i thoni Gjykatës se kur janë ndryshuar masat e sigurisë?

Pë. Nuk e mbaj mend.

Py. Në ndonjë moment pas datës 7, a ju ka raportuar personeli i sigurisë brenda zyrës së Prokurorisë lidhur me cilat do të ishin këto masa sigurie?

Pë. Mesa mbaj mend morëm një email.

Py. Keni marrë një email? A mund të flisni pak më shumë se ç'doni të thoni?

Pë. Lidhur me pyetjen tuaj nuk më informuan për masat e

sigurisë por mora një email.

Py. Pra kaq morët një email. Ky ishte njoftimi që morët lidhur me sigurinë, masat e sigurisë?

Pë. Me sa më kujtohet, po kemi marrë një email të hollësishëm.

[Mbrojtja këshillohet]

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Dua që për një çast t'i kthehemi pyetjes së nxjerrjes së materialeve apo çështjes së nxjerrjes. Dhe do të përpiqem të mos përsëris atë që thashë më herët. Ju e patë që në fillim të hetimit ishte përgjegjësia juaj si hetuese të shqyrtonit çdo informacion që mund të minonte çështjen e Prokurorisë apo që mbështeste çështjen e Mbrojtjes. Ju e kuptoni?

Pë. Po.

Py. Ju e kishit për detyrë ta raportonit këtë punonjësit të nxjerrjes së materialit apo Prokurorit?

Pë. Po, siç thashë kemi një sistem në zyrë sesi i trajtojmë çështje të tilla, kur përpara kësaj kur kam hasur informacion shfajësues ia kam raportuar Prokurorit. Kështu veprojmë edhe në Austri.

Py. Në Austri?

Pë. Unë jam punonjëse e policisë së Austrisë. Aty jam shkolluar. Aty na kanë mësuar këto gjëra.

Py. Pra ju e kuptoni këtë se keni detyrim - dhe në rastin e punës suaj këtu në ZPS?

Pë. Nuk e di nëse e kam unë si hetuese këtë detyrim. Por është detyrim i zyrës.
Py. I gjithë ekipit?
Pë. I zyrës.
Py. Po ju jeni anëtare?
Pë. Unë nuk po them që jam përjashtuar.
Py. Ju e pranoni se e keni për detyrë. Kur kryeni një hetim që të nxirrni materiale potenciale që mund të minojnë çështjen e Prokurorisë dhe të mbështesin çështjen e Mbrojtjes?
Pë. Unë jam pjesë e një zyre, e cila punon në një bazë të disa proceseve dhe duhet të zbatojnë këto detyrime. Nuk kam lexuar dikur që vetëm unë konkretisht duhet ta bëj këtë.
Py. Ju keni thënë se i keni parë, studiuar transkriptet e tre konferencave të shtypit si pjesë e përfshirjes suaj në këtë punë?
Pë. Po.
Py. E kemi vështirë akoma, s’e kemi gjetur se ku ndodhen.

Z. CADMAN: [Përkthim] Dosjet që kemi ne kanë një sistem me numra sipas rreshtave kurse ju se keni këtë sistem. Ky është problemi. Ne mund ta gjejmë besoj në bazë të këtyre numrave të rreshtave.

T’i kthehemi konferencës së parë për shtyp. Unë jam në faqen 2, rreshtat 15 deri në 17, jo më falni faqja 2, rreshtat 15 deri në 17.
Py. Versioni juaj është rreshti 2, faqja 2. Aty -

Pë. A mund ta zvogëloni faqen që ta shoh të gjithë faqen?
Py. Keni këtë përpara?
Pë. E kam faqen. Mund të më thoni cilin rresht?
Py. 1-2. Këtu shihni se z. Haradinaj përmend anëtarë të Parlamentit dhe përmend atë që ai e quan një Gjykatë mono-etnike.
Pë. E shoh.
Py. Po të uleni pak më poshtë rreshti 4, përmend bashkëpunimin me aparatin shtetëror të Miloshevіçit.
Pë. Po e shoh.
Py. Rreshti 8, aty shikoni që e kalon dokumentin. E shfleton.
Në të njëjtën faqe, paragrafi 3, rreshti 1 përmend përsëri të njëjtën gjë.
Në faqen 2, paragrafi 5 prapë përmend regjimin e Miloshevіçit, u referohet zyrtarëve serbë që janë përgjegjës për krimet e kryera në Kosovë.
Paragrafi i fundit, faqja 2, ai bën thirrje për llogaridhënie dhe akuzon ZPS-në se ka bashkëpunuar me ata që kanë torturuar dhe vrarë shqiptarët e Kosovës.
Faqja tjetër, rreshti 1.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë pyetje apo po bëni deklarata?
Z. CADMAN: [Përkthim] Po ia tregoj dëshmitares këto sepse nga këto është e qartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ime është kjo, keni një pyetje se prandaj është dëshmitarja këtu për t'i përgjigjur pyetjeve.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Kur i kini parë këto transkripte duke marrë parasysh disa nga referencat që ju përmenda, çfarë hapash ndërmorët?

Pë. Çfarë po thoni?

Py. Nga këto referenca që përmenda dhe pas atyre që thamë lidhur me detyrimin tuaj çfarë hapash ndërmorët ju që këto çështje t'i ngrinit me këdo të cilit i raportonit në atë kohë si çështje që mund të minonin çështjen e Prokurorisë apo mbështesin çështjen e mundshme të Mbrojtjes?

Pë. Unë i shqyrtova këto transkripte dhe detyra ime ishte që të identifikoj emra – ja në faqen 1 më duket – emra konkretë të cilët u përmendën - ju thatë më duket z. Haradinaj – nga z. Haradinaj dhe të kontrolloja nëse këto emra gjendeshin në paketë. Nuk e kisha për detyrë ta shqyrtoja dhe të raportoja për përmbajtjen. Unë i kam marrë dokumentet nga Prokurorja znj. Bolici.

Py. Pra nuk e patë si detyrën tuaj të bënit gjë tjetër përveçse të kontrollonit, të shihnit se çfarë emrash ishin përmendur nga z. Haradinaj?

Pë. Detyra konkrete që m'u dha mua ishte të kontrolloja për këto emra dhe këtë bëra. Po unë sigurisht e lexova të gjithë dokumentin.

Py. Një referencë tjetër që dëshiroj të përmend është në faqen 3. Është paragrafi që fillon: "Unë besoja se ishte e nevojshme ..."

Pë. E lexova.

Py. Siç mund ta shihni nga këto që z. Haradinaj thotë aty është se ai mendon se bënte këtë në interesin e publikut. Nuk është një çështje që, nuk iu duk se ishte diçka që duhet ta shikonit, ta shqyrtonit?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtojmë. Pyetja është bërë, ka marrë përgjigje. Dëshmitarja e sqaroi se ç'punë kishte, cila ishte detyra e saj prandaj është një çështje argumentuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e pranoj kundërshtimin. Pyetja është bërë disa herë, po ju lejoj ta bëni dhe njëherë dhe jo më tepër, mbarojmë me të.

Z. CADMAN: [Përkthim]

Py. Nuk ju duk se ishte një aspekt i rëndësishëm në shqyrtimin tuaj?

Pë. Detyra ime nuk ishte të sqaroja rëndësinë e të gjithë hollësive të dokumentit. Detyra ime ishte të kontrolloja për emra konkretë dhe t'i verifikoja ata.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman m'u kujtua se është fjala për P1 ta përmend që në procesverbal të dalë e qartë se ku po i merrni këto deklarata.

Z. CADMAN: Faleminderit i nderuar Gjykatës.

Dhe një pyetje tjetër, po duhet të kalojmë në seancë private për këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private ju lutem znj. Sekretare.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

*Riklasifikuar si publike dhe përfshirë në përputhje me urdhrin në F611/A3 të datës 18 maj 2022.*

Z. CADMAN: Mund të kalojmë në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë publike znj. Sekretare.

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera siç tha z. Rees mund të kemi nevojë ta thërresim edhe një herë dëshmitaren në një seancë të mëvonshme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë publike zonja Sekretare.

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: Për procesverbalin jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta thoni edhe njëherë këtë për publikun?

Z. CADMAN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

Jemi në seancë publike?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera për

dëshmitaren në këtë fazë por siç tha z. Rees mundet të kemi nevojë ta thërresim përsëri këtë dëshmitare.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Prokurore keni ndonjë pyetje shtesë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kam disa pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Siç e dini ZPS-ja lejohet të bëjë pyetje suplementare pra vetëm për çështje të cilat kanë dalë gjatë pyetjeve të Mbrojtjes. Këtë kemi thënë në paragrafin 77 të urdhrit [sipas përkthimit].

Ju lutem a mund të na thoni arsyen apo arsyet për pyetjet e tua shtesë?

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, u bënë disa pyetje gjatë pyetjeve që u bënë Dëshmitares nga Mbrojtja lidhur me konfidencialitetin e dokumenteve të paketës. Dëshmitarja dha disa përgjigje në lidhje me to dhe dua të kërkoj disa shpjegime lidhur me këtë temë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje vijuese nga znj. Bolici:

Py. Gjatë pyetjeve që ju bëri Mbrojtja përmendët se ju verifikonit nëse kërkesat për koordinim gjendet në bazën e të dhënave të ZPS-së, e saktë është?

Pë. Po.

Py. Janë ato në bazën e të dhënave të ZPS-së?

Pë. Po, janë.

Py. Kërkesat për koordinim gjenden në Paketën 1 si pjesë e të dhënave hetimore të ZPS-së dhe TFHS-së?

Pë. A mund ta përsërisni dhe njëherë?

Py. Kërkesat për koordinim në përgjithësi kërkesë për ndihmë në çështje penale, a janë ato pjesë e hetimeve të TFHS-së dhe ZPS-së?

Pë. Po, janë.

Py. Këto kërkesa për koordinim a kanë të bëjnë me hetimet e TFHS-së, ZPS-së?

Pë. Po.

Py. Mbështetur në përvojën tuaj si hetuese e TFHS/ZPS-së, të dhënat e hetimeve a janë konfidenciale?

Pë. Po, janë.

Py. Faleminderit. Në lidhje me Paketën 3, ju pyetën, ju bënë disa pyetje lidhur me konfidencialitetin e atij dokumenti.

Pyetja ime është kjo: Paketa 3 a ka të bëjë me, lidhet me hetimet e ZPS-së?

Pë. Po, lidhet.

Py. Ky dokument përmban ndonjë informacion me sa dini ju që nuk ishte bërë publik nga ZPS-ja?

Pë. Me sa di unë nuk ishte bërë publik.

Py. Përfshinte emra dëshmitarësh që ZPS-ja kishte intervistuar?

Pë. Po.

Py. Përfshinte referenca ndaj informacionesh dhe të dhëna që janë dhënë nga këto dëshmitarë?

Pë. Po.

Py. Me sa dini ju, ZPS-ja e ka bërë ndonjëherë publik ndonjë emër apo provë apo informatë të dhënë nga dëshmitarët e saj?

Pë. Me sa di unë jo.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kaq kisha unë lidhur me pyetjet shtesë të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit znj. Prokurore.

Trupi Gjykues ka disa pyetje për ju znj. Pumper. Po i afrohemi fundit.

Gjykatësi Mettraux ka disa pyetje për ju.

Keni fjalën.

Pyetur nga Trupi Gjykues:

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi Smith.

Përshëndetje znj. Pumper.

Unë dua t'ju bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me disa prej faktorëve që keni identifikuar në deklaratat tuaja dhe në shtojcat përkatëse që lidhen me treguesit e konfidencialitetit. Unë mbaj mend që më 20 tetor 2021 z. Rees ju bëri disa pyetje në lidhje me këta tregues. Dhe ai tha që paketat përbëheshin nga qindra faqe. A e mbani mend këtë pyetje të bërë nga z. Rees?

Pë. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: N.q.s. do të përsërisnit edhe njëherë shqyrtimet e këtyre paketave e sa shpesh dilnin këto tregues konfidencialiteti në dokumente të tilla, d.m.th. dilnin në çdo faqe, në çdo dy faqe, në çdo dokument? A mund të na thoni, a jeni në gjendje të na thoni sesa shpesh i shikonit tregues të tillë të konfidencialitetit në dokumentacion?

Pë. Të nderuar Gjykatës, po të shikoni dokumentin në spreadsheet që kam përpiluar mund të shikoni çdo dokument specifik dhe mund të shikoni numrin e faqeve të secilit prej dokumenteve. Për shembull mund të shikoni që dokumenti një përbëhet nga katër faqe dhe ka katër indikatorë apo tregues konfidencialiteti. Kështu që n.q.s. do shikoni këtë dokument besoj që merrni përgjigjen e pyetjes sipas secilit prej dokumenteve përbërës të paketës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a ka një tregues ose tregues potencial konfidencialiteti që diskutuat ju me z. Rees. A është njëri prej këtyre treguesve logoja SITF?

Pra unë dua t'ju pyes sepse mendoni ose pse konsideroni që prania kësaj logoje është një element që mund të përcaktojë nivelin e konfidencialitetit të këtij dokumenti.

Pë. Kur kam shqyrtuar dokumentet kam menduar për indikatorët e sugjerimit të konfidencialitetit. çra TFHS-ja është një institucion që ka hetuar krime që kanë ndodhur në një periudhë

të caktuar kohe. Kështu që për mua vetë institucioni mund të jetë tregues për lexuesin se informacioni që përmbahet ne dokumentin përkatës është konfidencial.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e konsideruat si indikator ose si tregues konfidencialiteti më vete apo e konsideruat këtë si pasojë e kombinimit të disa faktorëve me njërit tjetrin?

Pë. Të nderuar Gjykatës besoj që do ta shikoni nga dokumentacioni, nga spreadsheet-i që unë përmenda pak më sipër që unë nuk kam identifikuar qoftë një dokument të vetëm që ka përbërë ose që përmbante le të themi këtë logon e STHF-së indikator apo treguesin e vetëm të konfidencialitetit. Pra dokumentet përmbanin disa tregues.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani sa i takon një tjetër çështjeje që u shqyrtua nga avokati me ju. E kam fjalën specifikisht për bashkëpunimin me palët e treta. Pra e kam fjalën për bashkëpunimin e TFHS-së dhe ZPS-së me palët e treta. Z. Rees ju pyeti specifikisht për këto ballinat ose fletët shoqëruese të kërkesave për koordinim. A e mbani mend që jeni pyetur nga z. Rees për këtë?

Pë. Po, e mbaj mend.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni si praktikë përmbajtja e këtyre letrave për koordinim, a konsiderohej nga ZPS-ja dhe TFHS-ja si konfidenciale dhe n.q.s. përgjigjja është po, pse?

Pë. Siç e përmenda unë nuk kam punuar shumë kohë me TFHS-në, nuk është se kam shumë përvojë vetjake lidhur me të. Megjithatë ajo çfarë kam parë është kjo që këto kërkesa për koordinim ndonjëherë dërgoheshin në mënyrë të inkriptuar, elektronike për institucionet. Dhe kërkesat për koordinim përmbajnë letra ose le të themi emra të dëshmitarëve për shembull ndonjëherë edhe ballinat ose fletat shoqëruese të kërkesave për koordinim përfshijnë emrat ose shkurtimet e emrave të individëve të caktuar. Për shembull duam që të intervistohet X person.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të thotë kjo që përgjigjja konsiderohej si konfidenciale nga zyra juaj?

Pë. Po, besoj se po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Juve u pyetët gjithashtu edhe për shumë artikuj të medias, pra artikuj të botuar në media, të cilët përmbajnë dokumente që janë identikë ose thuajse ose potencialisht identikë me dokumentet e OVL-UÇK-së. Kam disa pyetje lidhur me këtë temë.

Pyetja e parë është kjo, a keni pasur ju njohuri se në kohën përkatëse, d.m.th. në shtator të vitit 2020 ka pasur një burim tjetër të të njëjtit informacion që mund t'i ketë dhënë këto dokumente për median. Pra me fjalë të tjera, a keni hasur informacion që mund t'ju sugjeronte që gazetarët apo mediat mund ta kishin marrë të njëjtin informacion nga një tjetër burim?

Pë. Jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sërish në temën e lajmeve të medias, të artikujve të medias. A e mbani mend afërsisht se sa prej këtyre artikujve kanë referuar shprehimisht origjinën e materialeve që kanë të bëjnë me këtë ngjarje d.m.th. me fjalë të tjera, sa artikuj ose cila është përqindja e artikujve kanë thënë shprehimisht që ata e kanë marrë informacionin që botuan nga UÇK-ja, nga OVL-UÇK-së?

Pë. Të nderuar Gjykatës sa për saktësim është një përgjigje që lidhet me pyetjen që më bëtë më parë. Besoj që një institucion mediatik pra tha që informacionin e kam marrë nga ZPS-ja. Këtë kam lexuar.

Sa i takon pyetjes së dytë, përgjigjja është që nuk e di. Nuk kam dijeni.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj të kaloj në një temë tjetër.

Me 25 tetor z. Rees ju bëri pyetje për disa individë dëshmitarë ose dëshmitarë potencialë, të cilët thuhet që kanë nxjerrë statusin e tyre si dëshmitarë. A i mbani mend këto pyetje?

Pë. Po, i mbaj.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Rees ju pyeti për një individ të caktuar dhe unë dua t’ju bëj një pyetje lidhur me të. Do të shkoj në një provë materiale dhe do t’ju kërkoja të mos e përdorni emrin e individit znj. Pumper por shikoni

deklaratën tuaj.

Është prova materiale P86 MFI. Është deklarata që keni dhënë më 29 tetor 2020. Numri i identifikimit është ERN 084015 deri në 084026 [sipas përkthimit]. Do t'i kërkoja sekretarisë që të shkojë në faqen 6, dokumenti me numër identifikimi ERN 084020.

Dua që të lexoni paragrafin 31 aty znj. Pumper.

A e mbani mend të jeni pyetur nga avokatët e të dy të akuzuarve lidhur me individin specifik që përmendet në paragrafin 31 të deklaratës tuaj?

Pë. Po e mbaj mend.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptojmë që çështja e Prokurorisë është që një prej të akuzuarve e ka thënë publikisht emrin e këtij personi si pjesë e një konference për shtyp apo konferencave për shtyp të organizuara. Dua t'ju pyes dhe sigurisht n.q.s. keni dijeni më thoni, a e dini ju sepse ky person i caktuar mund të ketë tërhequr vëmendjen e të akuzuarit? A keni ndonjë informacion specifik të lidhur me këtë person që ju mendoni mund të të shpjegojë sepse është përmendur emri i tij dhe jo emri i shumë dëshmitarëve të tjerë?

Pë. Nuk e di të nderuar.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju jeni pyetur gjithashtu edhe për praninë ose mospraninë e ERN-ve në dokumente të caktuara. N.q.s. e kam kuptuar siç duhet atë çfarë keni thënë,

ju keni thënë se disa prej dokumenteve që janë marrë, që u gjurmuan nga OVL-ja ishin ekzaktësisht të njëjtat me dokumente të cilat kishin numër ERN-je po ndërkohë disa prej tyre nuk kishin numër ERN-je. A e kam kuptuar qartë këtë?

Pë. Dokumenti që kemi sekuestruar ne nuk ka numër ERN-je.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Cili është përfundimi që mund të nxirrni ju lidhur me këtë pikë sa i takon origjinës së mundshme të rrjedhjes së informacionit? A nxirrni ndonjë përfundim ndonjë informacion që mund të nxirrni sa i takon mungesës së ERN-së nga dokumentet për të cilat folëm.

Pë. Do të spekuloja po të thoja diçka.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk do ju kërkoj të spekuloni znj. Pumper por do ju kërkoj informacion lidhur me një tjetër dokument që e përmendi z. Rees në marrjen e tij në pyetje. Është një dokument i cili ka ardhur nga autoritetet serbe dhe ju thatë që nuk ishit në gjendje të gjurmonit këtë dokument specifik nga rekordet, nga të dhënat e zyrës. Këtë pyetje ua bëri z. Rees më 22 tetor 2021. A e mbani mend këtë gjë?

Pë. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë mund të tregojë kjo gjë sa i takon origjinës së rrjedhjes së informacionit, d.m.th. fakti që ju nuk patët mundësi që ta gjurmonit këtë dokument specifik nga baza e të dhënave të zyrës tuaj.

Pë. Sërish mendoj se do spekuloja po të thoja diçka.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua të spekuloni znj. Pumper dhe ju jam mirënjohës për përgjigjet e dhëna.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Pumper kam edhe unë disa pyetje për ju lidhur me dëshminë që keni dhënë përpara Trupit Gjykues. Ju na thatë sot paradite që ju jeni drejtuesja e operacioneve të hetimit në ZPS, a e mbani mend që ta keni thënë një gjë të tillë?

Pë. Po.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mbi bazën e përvojës tuaj me TFHS-në dhe ZPS-në më pas, a keni arsye për të besuar se mund të ketë patur ndonjë anëtar të mëparshëm ose ndonjë anëtar aktual i ZPS-së mund të jetë i përfshirë në ndonjë mënyrë në dhënien e ndonjë nga informacionet të cilat përfshihen në paketat përkatëse dhe këtë informacion pra ia ka dhënë një person i tillë OVL-së?

Pë. Unë nuk kam asnjë informacion që ka ndodhur diçka e tillë.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni arsye për të besuar se ndonjë person që mund të ketë provuar nën udhëzimet ose kontrollin e ZPS-së ndonjë prej këtij informacioni OVL-së?

Pë. Nuk kam informacion lidhur me këtë gjë.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me aq sa dini ju, ZPS-ja a ka kryer ndonjë hap pasues për të përjashtuar përfshirjen e ndonjë anëtari aktual ose që ka qenë në të shkuarën me ZPS-në ose ndonjë person që ka qenë nën udhëzimet apo kontrollin e

ZPS-së sa i takon ofrimit të informacionit për OVL-në?

Pë. Të nderuar Gjykatës me respekt më lejoni të them që nuk kam asnjë informacion lidhur me thelbin e hetimit mbi këtë çështje, kështu që nuk mund t'i jap përgjigje pyetjes se çfarë është hetuar dhe çfarë nuk është hetuar. Nuk e kam këtë informacion.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit znj. Pumper. Faleminderit për informacionin.

I nderuar Kryetar i Trupit Gjykues nuk kam pyetje të tjera.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit zoti Kryetar.

Përshëndetje znj. Pumper.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam unë disa pyetje lidhur me kontrollin dhe sekuestrimin e dokumenteve të kryer prej jush dhe disa prej kolegëve tuaj të OVL-UÇK-së. Do të doja që Sekretares t'i kërkoj që të shfaqë në ekran dokumentet me numër identifikimi ERN 083846 deri në 083927. Mendoj që nuk është caktuar një numër P akoma.

Shumë faleminderit.

Znj. Pumper dua t'ju pyes së pari sesa kolegë tuaj ishin të përfshirë në operacionin e kontrollit dhe sekuestrimit atë ditë ose me fjalë të tjera sa njerëz nga ZPS-ja e kanë kryer këtë kërkim përfshirë dhe veten tuaj?

Pë. Të nderuar nuk e mbaj mend numrin e saktë, por nuk e di n.q.s. mund të them që kemi qenë nga shtatë deri në dhjetë

vetë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

A mund t'i kërkoj znj. Sekretare që së pari të na shfaqë në ekran faqen me numër identifikimi ERN 083894?

Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës nuk e di n.q.s. mund të pyes n.q.s. kjo është pjesë e provave materiale që mund të trajtojë kjo Dëshmitare?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është në listë, jo, nuk është në listë.

Z. REES: [Përkthim] Sigurisht që e kuptoj që Trupi Gjykues ka të drejtë. Nuk e di sesi ta formuloj drejtë po nuk e di nëse mund t'i referohem rregullores dhe rregullorja thotë që të prodhojë d.m.th. që të kërkojë ofrimin e provave materiale të cilat nuk janë parashtruar nga palët kur e shikon të arsyeshme. I referohem këtu specifikisht rregullit 132.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. REES: [Përkthim] Kjo bëhet sigurisht d.m.th. pasi janë shprehur palët dhe mesa di unë nuk është se është bërë një gjë e tillë.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do të vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Barthe. Do t'ju lëmë kohë më pas për të bërë pyetjet tuaja n.q.s. keni pyetje lidhur me këtë.

Z. REES: [Përkthim] Në rregull.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Fatkeqësisht në këtë fotografi mund të shikoni që sipër emrit tuaj është një kuti e zezë. Nuk e di n.q.s. mund të jeni më e saktë lidhur me pyetjen që ju bëra d.m.th. pyetja që ju bëra pak më përpara ishte që sa vetë nga ZPS-ja ishin të përfshirë atë ditë?

Pë. Më lejoni vetëm një moment ju lutem. Unë dhe tetë veta të tjerë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë nëntë veta gjithsej duke përfshirë edhe veten tuaj?

Pë. Po e saktë. N.q.s. mund të jem më e saktë mund të them që kishim edhe staf sigurie dhe personel tjetër, po ata nuk është se ishin të përfshirë në procedurën e kontrollit dhe sekuestrimit, ishin thjesht pjesë e skuadrës më të gjerë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mendoj se e thatë më përpara gjatë paradites që në kontrollin dhe sekuestrimin ishin të pranishëm dhe policia e Kosovës, jo në ndërtesë ndoshta po diku aty rrotull.

Pë. Po besoj se kanë qenë përgjegjës për perimetrin e dytë ose të tretë të sigurisë. Megjithatë nuk jam e sigurt.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Pumper, pyetja tjetër është që sa kohë zgjati operacioni dhe n.q.s. e mbani mend sa dhoma janë kontrolluar atë ditë?

Pë. Të nderuar Gjykatës do t'i referohesha këtij raporti që jep kohën ekzakte dhe ditën ekzakte të realizimit të kontrollit dhe sekuestrimit. Konfirmoj që bëhej fjalë për dy

kate me disa dhoma po nuk mund të konfirmoj dot ekzaktësisht numrin e dhomave.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

Ndoshta mund t'i kërkoj znj. Sekretare që të shfaqë në ekran dokumentin me numër identifikimi 083887.

Znj. Pumper besoj se mund të lexoni në fillim të faqes kohën kur ka filluar ky operacion.

Pë. Ora ka qenë 14 e 2 minuta (14.02).

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Znj. Pumper n.q.s. unë e mbaj mend saktë, sekuenca që pamë ne në video dhe kam përshtypjen që ju pamë ju aty, që ju thatë që dikush nga OVL UÇK-së shpërtheu derën gjatë ekzekutimit të urdhrit për kontroll dhe për sekuestrim. Ju lutem a mund të na jepni më informacion se kush e shpërtheu derën dhe pse?

Pë. Faton Klinaku e shpërtheu derën dhe sekuenca, rrjedha e ngjarjes ishin që kur ishin përpara derës së mbyllur ai më tha mua, "Hape me forcë". Dhe unë i thashë, "Jo, jo mos e hap me forcë se do të përpiqemi që të gjejmë një çelës". Unë u ktheva dhe ai e shpërtheu, e hapi me forcë derën.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju nuk mund ta thoni dot sepse e bëri një gjë të tillë ai?

Pë. Nuk e kam idenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja tjetër është kjo. A ka pasur probleme, shqetësime sigurie të cilat do të duhej të merreshin parasysh në përgjithësi gjatë planifikimit të këtij

operacioni nga zyra juaj, nga ju si nëpunëse ekzekutuese përgjegjëse për këtë?

Pë. Kishte çështje shqetësuese sigurie që duhet të merreshin parasysh. Një prej tyre është që unë si koordinatore e kontrollit duhet qe të shqyrtoja se çfarë mund të ndodhte jashtë. Duhet të merrja parasysh që sa kohë na duhej për të bërë kontrollin në këtë vend, i cili ishte goxha i shtrirë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A kishte shqetësime të përgjithshme apo specifike sigurie? Kur them specifike e kam fjalën për atë operacion specifik atë ditë.

Pë. N.q.s. e mbaj mend siç duhet pritej që të kishte grumbuj të mëdhenj njerëzish të grumbulluar përpara OVL-UÇK-së.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më lejoni ta bëj ndryshe pyetjen. Në përgjithësi si do të përshkruanit ju situatën për një zyrtar, nëpunës të ZPS-së që po ekzekutonte një urdhër kontrolli për anëtarët, pjesëtarët e mëparshëm të UÇK-së ose të ndërtesës së OVLUÇK-së, d.m.th. ishte e rrezikshme për juve kjo gjë apo ishte punë e zakonshme?

Pë. Lidhur me pjesën e pyetjes tuaj, n.q.s. ishte situatë e rrezikshme mendoj që pyetja duhet t'i dërgohet, duhet t'i bëhet personave të sigurisë. Pra unë jam përgjegjëse për tjetër gjë por ndërkohë është siguria ajo që është përgjegjësi sa i takon rrezikut dhe ata më thonë mua dhe kjo pastaj merret parasysh prej meje sa i takon shpejtësisë së veprimit dhe kohës që më duhet për të bërë këtë proces.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë edhe këtë bëtë juve?
Pë. Po.
GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sot paradite na thatë që kishte udhëzime specifike për sigurinë dhe për sa i takon ekzekutimit të urdhrave për kontrollin. A është e saktë kjo?
Pë. Po, e saktë është.
GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni që këto udhëzime sigurie janë respektuar prej jush dhe kolegëve tuaj gjatë asaj dite, d.m.th. me 25 shtator 2020?
Pë. Ajo çfarë kam parë, ajo çfarë, për të cilën unë kam qenë e pranishme vetë, kam parë me sytë e mija mund ta konfirmoj pozitivisht këtë gjë.
GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si mund ta përshkruanit ju atmosferën në këtë operacion krahasuar me operacione të tjera të kontrollit dhe sekuestrimit që keni kryer në të shkuarën qoftë si pjesë e ZPS-së, TFHS-së apo autoriteteve austriake apo gjermane?
Pë. N.q.s. do më jepni një minutë për t'u menduar. Për mua si profesioniste koordinimi i këtij kërkimi, këtij kontrolli në OVL UÇK-në ishte një projekt i madh, ishte shumë kërkues, bëhej fjalë për një ndërtesë të madhe, për një çështje të madhe, ishte kontrolli i parë kështu që po. N.q.s. mund ta them me pak fjalë, po, ishte goxha punë e madhe.
GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër,

nga videoja që pamë dje e kuptoj që i pranishëm ishte dhe z. Tomë Gashi, të paktën në një pjesë të hetimeve tuaja?

Pë. Me aq sa mbaj mend unë ai ka qenë i pranishëm gjatë gjithë kontrollit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni se çfarë funksioni kishte ai? Pse ishte i pranishëm atë ditë? Në çfarë funksioni ishte i pranishëm atë ditë?

Pë. Z. Gashi ishte caktuar si përfaqësuesi ligjor i OVL-së për të qenë i pranishëm gjatë kontrollit. Kjo është një kërkesë ligjore.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ishte i pranishëm edhe një vëzhgues i pavarur gjatë kontrollit dhe sekuestrimit?

Pë. Po, ishte.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Pumper, a është ankuar njeri për mënyrën si janë ekzekutuar kontrollet ose sekuestrimet si për shembull, z. Gashi ose nga dikush tjetër, nga OVL UÇK-së ose një tjetër vëzhgues i pavarur?

Pë. Të nderuar Gjykatës n.q.s. më lejoni do të dua të bëj dy komente lidhur me këtë pyetje.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po.

Pë. Do të doja të thoja së pari që z. Klinaku ishte përfaqësues i OVL-së në mungesë të z. Gucati dhe ai më tha personalisht që unë e kisha bërë misionin tim shumë mirë, pra kisha kontrolluar dhe kisha sekuestruar shumë mirë. Dhe z. Gashi që ishte përfaqësuesi ligjor i OVL-së, në një pikë më

tha që, "Boll bëtë zhurmë. E dini që po bëni siç duhet këtë punë, por po e bëni më mirë sesa ç'duhet". Ndërkohë që unë ju përgjigja që, "Ky është kontroll. Duhet të bëhet sipas kërkesave ligjore", dhe kështu vijuam. Kështu që do të çuditesha shumë n.q.s. do të dëgjonim të kundërtën.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Znj. Sekretare do t'ju kërkoja që të na shfaqnit në ekran dokumentin me numër identifikimi 083901.

Pë. A mund ta zvogëloni pak në mënyrë që të jetë e plotë faqja?

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E shikoni znj. Pumper?

Pë. Po, e shoh.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e keni thënë ju këtë?

Pë. Jo, nuk iu referova kësaj.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e mbani mend z. Klinaku të bënte një koment të tillë?

Pë. Unë e mbaj mend që z. Klinaku e tha këtë menjëherë sapo erdhi në OVL. Dhe kjo u theksua nga z. Gashi. Dhe këtë çështje unë e trajtove menjëherë sapo ma sollën në vëmendje.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të kalojmë tek një faqe më sipër? Faleminderit.

Znj. Pumper, këtu besoj që mund të shikoni një koment të bërë nga një vëzhgues i pavarur, është e saktë kjo?

Pë. Po e saktë është.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të lutem a e lexon dot këtë

koment për procesverbal?

Pë. "Nuk ka komente ose shqetësime. Procesi është kryer në mënyrë shumë profesionale".

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë ka shkruar vëzhguesi i pavarur në praninë tuaj në këtë dokument?

Pë. Po e saktë është kjo.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Pumper, ju vetë, ose ndonjë prej kolegëve tuaj me aq sa mbani mend ju, a ka shkruar një raport për kontrollin dhe sekuestrimin përveç videos që pamë? Dhe n.q.s. përgjigjja është pozitive, sa raporte janë shkruar prej jush ose prej të tjerëve?

Pë. Të nderuar Gjykatës, i vetmi raport që është prodhuar, është shkruar, është ky raport që po më tregoni tani. Nuk janë shkruar raporte të tjera shtesë. Unë e kam konsoliduar informacionin dhe e kam hedhur atë në këtë raport.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra ky është i vetmi raport që keni shkruar ju pas operacionit të kontrollit dhe sekuestrimit?

Do të doja që t'i kërkoja Sekretares që të shkojmë në dokumentin me numër identifikimi ERN 083846 që është faqja e parë. A mund të kalojmë tek faqja më poshtë ju lutem?

Paragrafi 8 deri në paragrafin 10, mund t'i shikoni këta paragrafë znj. Pumper? Dhe sërish a mund të thoni sesa raporte janë shkruar jo vetëm nga ju, por edhe nga kolegë të tjerë

tuajt në ZPS lidhur me këtë çështje?

Pë. Ju kërkoj ndjesë të nderuar Gjykatës. Kur e kam fjalën për raportet, e kam fjalën për raportin që kam konsoliduar, për këtë raport dhe raportet e tjera që ju janë shfaqur juve.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, a është e saktë se ka pasur një raport që quhet raport plotësues -- jo më falni. N.q.s. unë do t'i referohem paragrafit 8, pra bëhet fjalë për një raport për kontrollin e personave, ambienteve dhe/ose pronës. Ndërkohë që kemi edhe një raport tjetër që përmendet në paragrafin 9 që është raporti plotësues i kontrollit dhe pastaj kemi dhe raportin për kontrollin e personave, ambienteve dhe pronave të tjera të lidhur me shtatë vende të ndryshme, a është e saktë kjo?

Pë. Po, e saktë është.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra janë hartuar shumë raporte.

Pë. Po, ju kërkoj ndjesë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit është kjo, znj. Pumper, nëse e mban mend siç duhet termin që përdorët dje, ju thatë që, po përpiqeshit të ishit sa më përfshirëse të ishte e mundur. E mban mend siç duhet?

Pë. Po.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na e shpjegoni se çfarë donit të thoni me këtë?

Pë. N.q.s. më lejoni të jap pak më shumë shpjegim. Z. Gucati

kishte vendosur që z. Faton Klinaku do të ishte përfaqësuesi i OVL-së. Situata ishte e nxehtë dhe kishte goxha diskutime të zjarrta derisa në fund ne u futëm në ndërtesë dhe filluam me punën.

Diçka që gjithmonë kam mbajtur parasysh është fakti që unë mund ta realizoj këtë kontroll n.q.s. kam bashkëpunëtorë, d.m.th. në qoftë se z. Klinaku bashkëpunon me mua atëherë unë do të mund të bëj punën time, sepse në të kundërtën do të duhet të më gjejë një tjetër përfaqësues sepse nuk do të ishte në gjendje që të përqendrohej në kontroll.

Për mua, unë e pashë që ai ishte i irrituar, gjë e cila m'u duk shumë e natyrshme dhe për këtë arsye u mundova që kontrollin ta bëja në mënyrë sa më të natyrshme. Pra kishte një lloj fryme ose dukej që ai ishte i shqetësuar që ne ishim aty dhe pjesë e saj ishte që unë e lejova atë që të ishte më afër nesh. Ndërkohë që n.q.s. situata do të kishte qenë e ndryshme nuk do e kisha lejuar një gjë të tillë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Faleminderit për përgjigjet tuaja. Këto ishin pyetjet e mia.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky dokument u përdor thjesht për t'ia rifreskuar memorien dëshmitares në lidhje me tre pika, numrin e anëtarëve të ekipit që morën pjesë në kryerjen e kontrollimit në kohën e fillimit të kontrollimit dhe disa çështje të tjera, jo aq të rëndësishme.

Mund të pyetni në lidhje me këtë.

Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Rees:

Z. REES: [Përkthim] Ju faleminderit. Në lidhje me vëzhguesin e pavarur. Ai a u, atij, pra atë a e njoftuat në pika të shkurtra lidhur me çështjen?

Pë. Më falni, e keni fjalën për faktet e hetimit?

Py. Po. Ky vëzhguesi i pavarur, a u informua për çështje në lidhje me këtë çështje dhe do të jem më konkret se njëra çështje ishte ngritur nga z. Gucati vazhdimisht dhe i kemi kërkuar transkriptin për referenca në lidhje me press-konferencën. Njëra prej këtyre çështjeve ishte n.q.s. burimi i informacionit ishte vetë ZPS-ja. A ju tha kjo vëzhguesit?

Pë. Jo.

Py. Z. Faton Klinaku, a e dini n.q.s. ai kishte ndonjë farë përvoje në kryerjen e kontrolleve policore?

Pë. Nuk e di.

Py. Z. Klinaku për sa i përket ZPS-së, ishte edhe i dyshuar në këtë çështje apo jo?

Pë. Nuk e kam ditur këtë në kohën kur kam kryer kontrollin.

Py. Domethënë kjo nuk ka qenë pjesë e fakteve që kishte ZPS-ja. Pra ZPS-ja e trajtonte z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi si të dyshuar në atë çështje apo jo?

Pë. Nuk e kam ditur n.q.s. z. Klinaku në atë kohë konsiderohej i dyshuar në këtë çështje.

Py. Ju faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Cadman?

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi përfunduar me dëshminë tuaj. Do t'ju përcjellin tani jashtë në sallës gjyqit. Ju faleminderit që ishit e pranishme.

DËSHMITARJA: Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të marrim pushimin e drekës tani në mënyrë që të gjithë të përgatitemi për dëshmitarin tjetër. Ju lutemi kthehuni këtu në orën 1400.

[Dëshmitarja largohet]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A jeni të gjithë të disponueshëm që të ktheheni në atë kohë?

Z. REES: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, dua të ngre një çështje. Mund ta trajtojmë tani apo më vonë sot. Kemi përpara dëshminë e dëshmitarit me pseudonimin W04842 dhe këtë e kam ngritur edhe në fillim të javës që shkoi në lidhje me dëshminë e dëshmitares që shkoi, znj. Pumper por edhe në lidhje me dëshminë e dëshmitarit W04842. Kemi marrë një email në lidhje me sesionin përgatitor të dëshmitarit që ka të bëjë me një farë informacioni të ri.

Nuk ka indikacion për ndryshim të ndonjë deklarate të tij mirëpo thjesht dua ta di të dëgjoj nga Prokuroria n.q.s. do të bëjë pyetje në lidhje me atë informacion të ri, të marrë dhe që lidhet me atë dëshmitar. Atëherë në atëherë rast, do të

duhej që dëshmia e dëshmitarit të përqendrohet edhe në atë fushë në mënyrë që në bazë të kësaj mund të nxirret informacion më vonë.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani Prokuroria tashmë i është përgjigjur kësaj kërkese duke mbajtur parasysh rregullin 102 të Rregullores, ku përcaktohet se dëshmitë e dëshmitarit nxirren, por nuk parashikohet dhënia e një njoftimi në lidhje me to. Është dhënë njoftim dhe është dhënë edhe përmbledhja e deklaratës sipas rregullit 95.

Z. REES: [Përkthim] N.q.s. ZPS-ja i qëndron pas këtij mendimi edhe tani, atëherë dua t'i drejtohem Trupit Gjykues më gjatë dhe më hollësisht në lidhje me këtë, se duhet të zhvillojmë një farë parashtrimi në lidhje me disa rregulla. Për mendimin tonë, rregullat përcaktojnë se kur duan të nxjerrim dëshminë e një dëshmitari duhet paraprakisht të jepet një deklaratë e dëshmitarit ku përcaktohet edhe fushëveprimi i asaj deklarate.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë bëni parashtrimin tani z. Rees.

Z. REES: [Përkthim] Rregulli 102(1)(b) kërkon nga Prokurori i Specializuar që t'ia japë Mbrojtjes "brenda afatit të caktuar nga Trupi Gjykues por jo më vonë se 30 ditë përpara deklaratës hyrëse të Prokurorit:

"(i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët

Prokurori ka ndërmend t'i paraqesë në gjykim;

"(ii) të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, depozitimet apo raportet e Prokurorit të Specializuar që do t'i paraqesë në gjykim apo që ka ndërmend t'i paraqesë; dhe

"(iii) provat materiale që Prokurori i Specializuar ka ndërmend t'i paraqesë në gjyq".

Rregulli 102(2) thotë se:

"Çdo deklaratë apo dëshmitarë shtesë të Prokurorit të Specializuar që nuk i është dhënë brenda Mbrojtjes, brenda afatit të caktuar kohor në paragrafin (1)(b) dhe të cilin Prokurorja e Specializuar ka ndërmend të thërrasë në gjykim, duhet t'i jepet Mbrojtjes sa më shpejt që është e mundur dhe duhet të shoqërohet me arsyetimin për nxjerrjen e vonuar të materialit".

Rregulli 102(4)thotë:

"Nxjerrja mbas paragrafit (2) duhet të finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake. Më pas Prokurori i Specializuar duhet të japë një njoftim për çdo nxjerrje të re materiali së bashku me arsyetimin përkatës për nxjerrjen e vonuar.

Rregulli 102 dhe detyrimet aty. Në rregullin 143 bëhet fjalë për ekzaminimin e dëshmitarëve. Rregulli 143(1) përmend shprehimisht deklaratat paraprake të dëshmitarëve dhe thuhet se:

"Pala që bën pyetjet mund të marrë në pyetje dëshmitarët dhe të sigurojë se çdo dokument apo provë tjetër në përputhje

me rregullat n.q.s. dëshmitarit nuk i kujtohen faktet nga një deklaratë e dhënë paraprakisht. Atëherë dëshmitari brenda me lejen e panelit apo Trupit Gjykues mund t'i tregohen dokumente për t'ia rifreskuar atij memorien".

Rregulli 143 gjithashtu përmend deklaratat paraprake të dëshmitarit dhe aty thuhet, nëse dëshmitari ka dhënë në çfarëdo kohe një deklaratë të menjëhershme mospërputhjeje, çdo deklaratë e tillë mospërputhjeje mund të jetë e pranueshme për vlerësimin e besueshmërisë të dëshmitarit si edhe vërtetësinë e përmbajtjes të saj ose për qëllime të tjera sipas gjykimit të Trupit Gjykues".

Duket qartë se rregullat 153, 154 dhe 155 kanë të bëjnë me deklaratat me shkrim të dëshmitarëve dhe pranimin e tyre në vend të dëshmisë gojore apo marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje.

Shkurtimisht n.q.s. një dëshmitar thërritet për të dhënë dëshmi, nxjerrja e provave apo dëshmisë që ZPS-ja ka ndërmend të marrë nga ai dëshmitar duhet t'i nxirret Mbrojtjes paraprakisht në formën e një deklarate dëshmitari dhe kjo i mundëson, mundëson rifreskimin e kujtesës në përputhje me rregullin 143 të Rregullores dhe gjithashtu mundëson që gjatë kundërpyetjeve për dëshmitarin në lidhje me një deklaratë të nënshkruar të dëshmitarit të dhënë në një fazë të mëhershme ku përcaktohet edhe përmbajtja e asaj deklarate.

Ka edhe dispozita shtesë në lidhje me nxjerrjen e

materialeve që dalin nga rregulli 95 për dhënien e një përmbledhjeje të fakteve për atë se çfarë do të dëshmojë secili prej dëshmitarëve. Një nxjerrje e tillë nuk është e domosdoshme dhe kjo në fakt heq detyrimin e dhënies apo vënies në dispozicion të deklaratës të dëshmitarit.

Në qoftë se kjo është e saktë, atëherë zbatueshmëria e rregullit 102(1) pezullohet. Dhe ZPS-ja nuk duhet të bëjë një nxjerrje adekuate por thjesht duhet t'i japë një përmbledhje të fakteve Mbrojtjes. N.q.s. do të vepronte kështu dhe do të lejohej të vepronte kështu rregulli 143 e Rregullores në lidhje me rifreskimin e memories të dëshmitarëve për ndonjë deklaratë të mëparshme, në këtë mënyrë nuk do të ishte e mundur që të bëhej një rifreskim i tillë i memories dhe në fakt kundërpyetjet do ta vendosnin Mbrojtjen në një pozitë jo të drejtë meqë nuk do të mund t'i merrte Mbrojtja në pyetje dëshmitarin ashtu siç duhet. N.q.s. tani këtë që përshkruhet si informacion i ri e kemi marrë në formë të një emaili prej z. James Pace, kjo nuk ka ardhur nga dëshmitari vetë. Dhe ne nuk mund t'i bëjmë kundërpyetje dëshmitarit në lidhje me atë dokument, me atë email, sepse kjo nuk është një deklaratë e tij. Prandaj ka një farë mospërputhjeje midis dëshmitarit dhe asaj që shënohet aty nga ana e z. James Pace.

Nuk e kemi prekur deri tani pikën e futjes jozyrtare të koncepteve të një deklarate nga ana e ZPS-së në këto procedura në krahasim me deklaratat e dëshmitarëve. Kemi theksuar se

edhe kur jepen deklarata, ato të paktën shoqërohen me një deklaratë se, dëshmitari vërteton që faktet dhe informacioni i përmbajtur në atë deklaratë janë të sakta me aq sa di dhe beson ai/ajo dhe ne mendojmë se kjo deklaratën për sa i përket vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratës së dëshmitarit duhet të jetë e nënshkruar.

Në lidhje me dëshmitarin W04842 kemi deklarata të tillë të vërtetësisë por vetëm për një aspekt të ngushtë të dëshmisë së tij dhe në këto rrethana ne kërkojmë një deklaratë të dëshmitarit në lidhje me çështje që mbulohen me deklaratat ekzistuese të tij.

Për aq sa ZPS-ja ka ndërmend të nxjerrë dëshminë në lidhje me atë që e përshkruan si informacion të ri: E para,

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më ngadalë z. Rees.

Z. REES: [Përkthim] Masa të tilla kanë të bëjnë me shpërnguljen, vendosjen e dikujt në një shtëpi të sigurt dhe iu referohet personave si, referimi i personave në programin e mbrojtjeve të dëshmitarit.

E dyta, kur merret vendimi, secili dëshmitar duhet të kontaktohet pas shpërndarjes së paketave - shërbimi i sigurisë së dëshmitarëve i ZPS-së kontrollojnë të gjithë emrat në materiale dhe pastaj i kontaktojnë ata persona.

Dhe e treta, W04842 ka qenë i pranishëm në mbledhjet dhe në kontaktimet e dëshmitarëve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees mendoj që ky është thelbi i argumentit tuaj.

Z. REES: [Përkthim] Ky informacion që përshkruhet si informacion i ri, ndoshta është i ri për ne por nuk është i ri për Zyrën e Prokurorit të Specializuar sepse dëshmitari W04842 është një zyrtar i ZPS-së dhe ka qenë në ZPS gjatë gjithë kohës.

ZPS-ja n.q.s. do të marrë dëshminë e tillë, mbi këtë bazë duhet të japë një deklaratë të nënshkruar me një konfirmim nga dëshmitari se informacioni në atë deklaratë është i vërtetë dhe i saktë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju faleminderit z. Rees. Vetëm disa qartësime. Ju jeni njoftuar për këtë informacion më 14 tetor të këtij viti. A është kjo e saktë, d.m.th. para dy javësh?

Z. REES: [Përkthim] 14 tetor, po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sikurse thatë ky informacion ka të bëjë me tre fusha apo aspekte të ngushta siç thatë edhe ju vetë apo jo?

Z. REES: [Përkthim] Nuk e di sesa e ngushtë do të jetë fusha që do të mbulojë ajo dëshmi sepse nuk e dimë se çfarë ka ndërmend dëshmitari të thotë në lidhje me ato aspekte.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë dua ta kuptoj më mirë këtë z. Rees. Ju thoni se keni përjetuar, jeni të paragjykuar nga fakti që nuk ju kanë dhënë deklaratën e dëshmitarit. A

mund të na thoni atëherë se çfarë ndryshimi do të bënte një deklaratë e nënshkruar nga dëshmitari për sa i përket përgatitjes që duhet të bëni ju si Mbrojtje?

E dyta, ju keni sugjeruar se ju nuk mund të merrni në pyetje siç duhet dëshmitarin pa një njoftim të tillë që nuk është i nënshkruar. Tani a mund ju t'i bëni pyetje këtij dëshmitari për këto tre pika në fillim të kundërpyetjeve dhe përsëri unë nuk e kam ndërmend t'ju jap udhëzimin se ju e dini si ta bëni detyrën e juaj. A mund të ndiqet një procedurë e tillë në mënyrë që ju të jeni të sigurt se e keni mendimin e dëshmitarit për këto tre aspekte?

Z. REES: [Përkthim] Së pari nuk jemi, nuk e kemi për detyrë që të cekim në këtë fazë paragjykimet ndaj nesh. Për mendimin tonë rregullat janë shumë të qarta dhe nuk kemi nevojë ne që të dëshmojmë se jemi të paragjykuar si palë n.q.s. ZPS-ja i injoron rregullat.

E dyta, paragjykimi del sikurse shënohet edhe në rregullin 102 dhe në rregullin 143 për mendimin tonë. Kur ZPS-së i lejohet të vendosë një të pandehur në një situatë kur dëshmitari për sa i përket Mbrojtjes nxjerr një informacion të ri.

Po, i nderuar Gjykatës, n.q.s. Prokuroria ka të drejtë të thërrasë dëshmitarë, unë mund t'i bëj dëshmitarit pyetje të tilla, ta pyes për shembull, paragrafi 1,2,3 të këtij emaili, dhe ai mund të më thotë, "Kjo nuk është e saktë. Kjo nuk është

ajo që kam thënë unë”. Dhe në krahasim me një deklaratë të nënshkruar të dëshmitarit kemi të bëjmë me diçka krejtësisht tjetër. Në atë rast unë mund t’i them dëshmitarit me plot siguri, “Kjo është deklarata jote. Këtë e ke nënshkruar dhe e ke konfirmuar dhe ke thënë se është e saktë me aq sa të kujtohet dhe me aq sa di më së miri”.

Nuk jemi tani në një fazë kur dëshmitari W04842do të japë dëshmi. E kam të qartë mendimin e Trupit Gjykues që mori javën që shkoi në lidhje me znj. Pumper. Unë thjesht dua të kuptoj se cili është kundërshtimi pse pra ZPS-ja nuk dëshiron që të japë një deklaratë të nënshkruar të dëshmitarit ku përcaktohet dëshmia që do të japë ai dëshmitar dhe këtë të bëjë para fillimit të dhënies së dëshmisë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t’ia jap fjalën Prokurorisë që të qartësohet vetë, mirëpo ajo që kërkoni ju, për mendimin tim z. Rees, ju i tejkaloni rregullat sepse në bazë të praktikës, në shumë juridiksione të tjera kanë ndodhur raste kur janë bërë shtime apo plotësime në momentin e fundit të deklaratave të dëshmitarëve me kushtin që ajo dëshmi të mos i shkaktojë paragjykim palës tjetër. Z. Rees ne do të marrim vendim në lidhje me kërkesën tuaj, mirëpo kjo do të jetë edhe pjesë e parashtrimeve që do të bëjnë kolegët tuaj.

ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I gjithë parashtrimi i Mbrojtjes bazohet në premisë me faj. Të gjitha rregullat nuk parashikojnë që dëshmitari i mëparshëm, që ka dhënë dëshminë e

mëparshme të thirret të dëshmojë. Pra nuk është e thënë që këto tema të jenë trajtuar në një deklaratë të mëparshme. Rregulli 95 tregon se palës kundërshtare i duhet dhënë njoftim për faktet, rrethanat për të cilat do të dëshmojë dëshmitari i Mbrojtjes, i është dhënë një njoftim i tillë në prill dhe në tetor të këtij viti dhe nëpërmjet takimeve përgatitore që u zhvilluan sipas Nenit 93 të urdhrit tuaj lidhur me kryerjen e procedurave.

Dua të theksoj gjithashtu se praktika e tribunalëve të tjerë ndërkombëtarë që kanë një kuadër të ngjashëm rregullash konfirmojnë se nuk kanë nevojë që të dërgosh, të japësh deklarata të mëparshme të dëshmitarëve për dëshmitarë që thirren për të dëshmuar drejtpërdrejt kur nuk ekzistojnë deklarata të tilla.

Dhe e kam parasysh në çështjen Prokurori kundër Hadziç, për të mos lejuar paraqitjen e deklaratës pastaj deklaratës së tij të 2013-s dhe vendim i ngjashëm i të njëjtës natyrë.

Mbrojtja i referohet rregullit 143 të Rregullores dhe faktit se përmendet deklarata e dëshmitarit. Fakti që mund të merren deklarata dhe mund të përdoren nuk do të thotë që ato duhet të përdoren gjatë paraqitjes së dëshmisë nga një dëshmitar drejtpërdrejt apo se duhen përdorur gjatë pyetjeve nga Mbrojtja. Ato pyetje duhen bërë për thelbin e çështjes, të cilat i janë bërë të njohura Mbrojtjes sipas mënyrave të parashikuara në rregullin 95 dhe siç vihet në dukje në urdhrin

tuaj për kryerjen e procedurave.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Rees, paragrafi që znj. Bolici përmendi është paragrafi 93, 53 për Kryerjen e Procedurave, pra dhënia e informacionit të ri gjatë seancave përgatitore të dëshmitarit.

Ju keni pasur mundësi t'i bënit parashtrime Trupit Gjykues për këtë në bazë të këtij paragrafi.

Z. REES: [Përkthim] Unë nuk kam problem me këtë propozim që, kur një dëshmitar bën një sqarim apo një ndryshim apo një korrigjim në përmbajtjen e deklaratës ekzistuese të tij/saj, n.q.s. ky është një material që i është bërë i njohur Mbrojtjes në bazë të faktit që është me rëndësi për përgatitjen e saj apo n.q.s. është një çështje shfajësuese nuk kam problem që të vijë një gjë e tillë nëpërmjet emailit.

Por këtu kemi të bëjmë me një situatë tjetër. Prokuroria kërkon në një fazë të vonë, të marrë dëshmi krejtësisht të re nga një dëshmitar. Dhe n.q.s. është një praktikë në tribunalë të tjerë që kjo të trajtohet nëpërmjet informalisht me email.

Ne e dimë sepse e kemi përdorur. Rregulli 102 dhe përdorimi i tij në këtë Gjykatë është një avancim material krahasuar me rregullat e tribunalëve të tjerë dhe kemi konfirmuar se regjimet e nxjerrjes së materialeve sipas rregullit 103 janë një avancim i kësaj metode të përdorur nga tribunalët e tjerë. Prandaj unë do t'ju lutesha të përqendroheshit te jurisprudenca që po përgatitet, po

zhvillohet në Gjykatën Speciale.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] N.q.s. dëshmitari vjen për të dhënë dëshmi për një çështje që nuk e përmbante deklarata e tij e mëparshme, do ta keni gjithmonë mundësinë t'i bëni pyetje për këtë dëshmi të re.

Z. REES: [Përkthim] Po, dhe unë do t'i them: Të është kërkuar të japësh një deklaratë, të nënshkruaje atë që mendon se është e re dhe nuk e ke bërë në deklaratë. Është një shpikje e re por nuk mund ta bëj këtë pa pasur deklaratën.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Rees, a ka ndonjë gjë që ju pengon, që gjatë pyetjeve që do t'i bëni dëshmitarit ta pyesni për informacion që ju është dhënë me mirëbesim lidhur me korrigjimet, apo informacion të ri që mund të ketë dhënë dëshmitari. A ka diçka në botë që t'ju pengojë ju të bëni këtë në bazë të emailit që keni marrë?

Z. REES: [Përkthim] N.q.s. dëshmitari do të japë dëshmi që është sipas përmbajtjes së paragrafëve 1,2 dhe 3 nuk ka problem. Po unë dyshoj që s'do të ndodhë kështu. Do të jetë vështirë që ta përmbash dëshmitarin brenda këtyre paragrafëve se e marr me mend që do të duan të shtjellojnë më tej ato që përmbajnë këta paragrafë.

Lidhur me pyetjen tuaj konkrete, me atë email, po mund ta pyes dëshmitarin që dikush ka mbajtur shënim për këto paragrafë. Por nëse dëshmitari thotë, "E di z. Rees, po e thashë këtë, thashë atë, thashë më shumë, nuk e thashë këtë,

nuk është hera e parë sepse i kam thënë për shembull z. Pace”, por unë nuk mund t’i them atij, ja ku e ke deklaratën e nënshkruar që deklarata është e vërtetë dhe ta pyes pse s'ka për shembull përputhje midis dëshmisë dhe deklaratës së tij të nënshkruar. Ky është dhe qëllimi i rregullit 103 [sipas përkthimit], i cili përcakton nëse është qasja që ndiqet në tribunalët e tjerë ndërkombëtarë, është qasja standarde që ndiqet në të gjithë juridiksionet e të drejtës penale kontinentale. Pra nuk duhet që në këtë rast të paraqitet një deklaratë e nënshkruar. Pra në rastin konkret atij mund t’i paraqitet një dëshmi e tillë dhe i freskohet kujtesa.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Faleminderit z. Rees. Do të japim një urdhër me gojë për këtë. Faleminderit shumë.

Do të ndërpresim punën tani dhe do shihemi në orën 2.30.

--- Pauza fillon në orën 13.04

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita. Jemi gati të fillojmë me dëshmitarin tjetër z. Berisha.

Konstatoj se avokati Arianit Koçi. Koci apo Koçi?

Z.KOCI: Koci.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Koci. Arianit Koci është në sallën e gjyqit.

Për procesverbal, ne konstatojmë se në një vendim të 8 tetorit 2021, me numër F355, ne lejuam dëshmitarin të ketë si shoqërues avokatin gjatë kohës që do të merret në pyetje në

sallën e gjyqit.

Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin.

Z. HALLING: [Përkthim] A mund të ngremë dy çështje që dolën nga seancë e përgatitjes dje, për procesverbal.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. HALLING: [Përkthim] Të dy janë përfshirë në regjistrin e përgatitjes.

Dëshmitari që do të vijë, deklaroi se kishte disa gabime në transkriptin në gjuhën shqipe të deklaratës. Kërkuam që njësia përkatëse ta shikonte këtë.

Për shkak të kësaj çështjeje dhe për faktin që ky flet mirë anglisht dhe anglishtja është shumë mirë kurse -- me përjashtim të një emri, do të përdorë deklarata në anglisht në qoftë se do të më duhet t'ia freskoj kujtesën atij. Nuk do të përdorim versionin e traskriptit në shqip që kishim menduar ta paraqisnim në listën e provave.

Nëse Mbrojtja dëshiron të përdorë atë version, sot do t'i japim një version të korrigjuar.

Çështja e dytë, nga dy -- është se dëshmitari dje tha se në fillim të dëshmisë donte t'i drejtohej Trupit Gjykues se nuk po dëshmon me vullnet të lirë. Në fakt, ai u thirr këtu, por doja që të trajtoja çështjen e vetë inkriminimit përpara se të vijë dëshmitari.

Gjatë gjithë kohës mendimi i zyrës sonë është se W04842

është dëshmitar dhe jo i dyshuar. Ai është intervistuar si i dyshuar [sipas përkthimit] dhe z. Koci është këtu i pranishëm me kërkesën e dëshmitarit.

Ne nuk do ta procedojmë këtë dëshmitar për asgjë që ai ka bërë në lidhje me këtë çështje. Për shkak të natyrës së sjelljes dhe për gamën e kufizuar të asaj që ai ka publikuar dhe ajo që ka më rëndësi, synimi i tij gjatë gjithë veprimeve për të mbrojtur dhe kthyer informacionin konfidencial, nuk ka kryer asnjë krim.

Pra, nuk do ta procedojmë.

Trupi Gjykues ka vendosur se në këtë moment nuk ka nevojë për garanci për mos vetëdiskriminim dhe ne i përmbahemi këtij vendimi, me përjashtim në qoftë se ndryshojnë rrethanat gjatë dëshmisë së tij.

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi asgjë lidhur çështjen e parë. Por për të dytën ne i kemi paraqitur shqetësimet tona lidhur me përkthimin. Kishim kërkuar kopje të intervistës që të intervistoheshin -- që të verifikoheshin intervistimet e tij.

Pra, do të na duhet që ta verifikojmë, por këto shqetësime i kemi ngritur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kur keni ndërmend t’i verifikoni këtë versionin e fundit?

Z. CADMAN: [Përkthim] Kur të na japë Prokuroria versionin e korrigjuar?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk do t'i bëni pyetje dot sot?

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk e di sesa kohë i duhet Prokurorisë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Besoj do të kesh kohë gjatë natës ta bëni këtë.

Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se të ndihmon Prokurori na tha Njësia e Përkthimit që nuk panë ndonjë ndryshim të madh në transkript dhe shpresojmë që të mund ta nxjerrim dhe gjatë kësaj seance.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] z. Koci. Jeni, ndiheni mirë që të vazhdojmë në anglisht me dëshminë e tij.

Z. KOCI: [Përkthim] Po, po meqenëse është një gjykatë kosovare, me lejen tuaj unë, do të flas në shqip.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Z. KOCI: [Përkthim] Unë mund të flisja edhe në anglisht, po do flas në shqip.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vetëm që flisni ngadalë, ju e dini procesin që të mund të përkthehet.

Faleminderit shumë që keni ardhur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Tani mund të thërrisni dëshmitarin.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jeni gati z. Berisha? Mirëdita.

Sektarja tani do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne që duhet ta bëni në bazë të Rregullores, në bazë të rregullit 141(2).

Ju lutem, bëjeni.

DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

Dëshmitari: HALIL BERISHA

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Berisha. Jepjani përsëri letrën Sekretares.

z. Berisha mesa kuptoj doni të bëni një deklaratë të shkurtër lidhur me faktin që keni ardhur këtu të dëshmoni; kështu?

DËSHMITARI: [E padëgjueshme] -- shkëlqesia juaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni tani.

DËSHMITARI: Po. Unë veç desha të them që nuk jam shumë i lumtur që sot jam këtu për dëshmuar para juve. Kjo asgjësi nuk ka me e pengu faktin që unë kam me thënë veç të vërtetën. Megjithatë, unë këtu jam se më keni obliguar. Po përndryshe nuk jam shumë i lumtur që sot gjindem këtu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kuptojmë. E kuptoj se jeni thirrur për të ardhur këtu. Dhe, sigurisht, bashkë me ju është edhe avokati. Në qoftë se keni pyetje, ne do t'ju lejojmë të konsultoheni me avokatin. E kuptoni?

Uluni, ju lutem.

Faleminderit, znj. Sekretare.

Z. Berisha, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, e cila pritet të vazhdojë deri nesër. Siç mund ta dini, Prokuroria do t'ju bëjë së pari pyetje dhe pasi të mbarojë Prokuroria, Mbrojtja ka të drejtë t'ju bëjë pyetje nga ana e saj. Anëtarët e Trupit Gjykues, po ashtu, mund të kenë pyetje për t'ju bërë.

Vlerësimi i kohës që do t'i duhet Prokurorisë për pyetje është tre orë. Mbrojtja një ditë. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë nga Prokuroria në qoftë se do të kërkohet.

Ju lutem, përpiquni t'i përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Nëse se kuptoni një pyetje mos nguroni që të kërkoni t'jua përsërisin apo se nuk e kuptoni dhe ata do t'jua sqarojnë. Ju lutem, përpiquni të vini në dukje ku i bazoni njohuritë, faktet për të cilat do t'ju pyesin apo rrethanat.

Trupi Gjykues e kupton, siç e thamë, se jeni thirrur zyrtarisht nga Prokuroria për të ardhur këtu në përputhje me rregullin 121, paragrafi 2, të Rregullores, që do të thotë jeni i detyruar të paraqiteni para nesh për të dhënë dëshmi.

Gjithashtu, Trupi Gjykues u informon se keni të drejtën të mos inkriminoni veten dhe se mund të kundërshtoni të jepni dëshmi të cilat mund t'ju inkriminojnë. Gjithashtu, lejoheni të konsultoheni me avokatin sa herë që mendoni se pyetja -- përgjigja juaj mund t'ju inkriminojë.

Në qoftë se Trupi Gjykues mendon se, megjithatë, duhet t'i jepni përgjigje një pyetjeje konkrete, mund të vendosim t'ju detyrojmë t'i përgjigjeni. Në atë rast mund të vendosim t'ju japim, t'ju sigurojmë lidhur me vetë inkriminimin, por këtë do ta bëjmë vetëm nëse është e nevojshme. Dhe do t'ju njoftojmë për procedurën konkrete në atë -- në një rast të tillë. Jam i sigurt se avokati mund t'ju këshillojë më mirë lidhur me këto çështje.

Ju lutem, flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se t'i përgjigjeni pyetjes dhe pastaj flisni me ngadalë me qëllim që përkthyesit të mund t'ju përkthejnë.

Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë Gjykatë, nuk lejoheni të diskutoni me njeri, përveç me avokatin për përmbajtjen e dëshmisë suaj. Në qoftë se ndonjë person tjetër përveç avokatit ju bën pyetje jashtë Gjykate lidhur me dëshminë tuaj, ju lutem na vini në dijeni.

Z. Prokuror, mund të filloni.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

Pyetje nga z. Halling:

Py. Mirëdita z. dëshmitar.

Pë. Mirëdita.
Py. Z. dëshmitar, do t’ju bëj pyetje, do fillojmë me emrin tuaj: Si ju quajnë?
PËRKTHYESJA: [Përkthim] Flisni pak më afër me mikrofonin, ju lutem.
DËSHMITARI: Unë quhem Halit Berisha.
Z. HALLING: [Përkthim]
Py. Faleminderit zotëri. Kur keni lindur?
Pë. 28 shkurt 1994.
Py. Ku keni lindur?
Pë. [E padëgjueshme].
Py. Kjo ndodhet në Kosovë; kështu?
Pë. [E padëgjueshme].
Py. Çfarë shkolle keni bërë?
Pë. Baçelor.
Py. Z. Berisha çfarë gjuhësh flisni?
Pë. Gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.
Py. Z. Berisha, ku keni punuar në shtator të vitit 2020?
Pë. Në gazetën InFokus.
Py. Çfarë pune bënit te gazeta InFokus?
Pë. Si gazetar dhe redaktor.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni, Bëheni dhe njëherë pyetjen. Paskemi një problem teknik me mikrofonat e z. Haradinaj.
Punon tani?

I AKUZUARI HARADINAJ: Folëm me ndërpremje ose ai se ka fol aty afër mirë ose këtu s'e ka me transmeton mirë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju lutem të gjithëve, të flisni pranë mikrofonit.

Vazhdojmë.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

Py. Z. Berisha, çfarë pune keni bërë te gazeta InFokus?
Pë. Gazetar edhe redaktor.
Py. Na përshkruanit punën që bënit si gazetar, ju lutem?
Pë. Si gazetar kam gjetur tema, kam shkruar tema edhe në raste të caktuara kam redaktuar tekste, tema.
Py. Ku e kishit zyrën te gazeta InFokus?
Pë. Në qendër të Prishtinës, përballë sheshit Bill Clinton.
Py. Z. Berisha, vazhdoni të jeni gazetar?
Pë. Për momentin nuk e ushtroj profesionin e gazetarit.
Py. Kur pushuat së punuari për gazetën InFokus?
Pë. Në fund të shtatorit të vitit 2020.
Py. Përse e latë punën në shtator 2020?
Pë. Kam filluar studimet në Gjermani.
Py. Z. Berisha, si gazetar për çfarë temash shkruanit për gazetën InFokus?
Pë. [E padëgjueshme] -- ditore po dhe tema të ndryshme. Nuk ka qenë e specifikuar.
Py. Ke shkruar ndonjëherë për OVL UÇK-në?
Pë. [E padëgjueshme].

Py. Ke pasur ndonjë kontakt profesional me këtë organizatë?
Pë. Si gazetar për temat që kam shkruar kam kontaktuar edhe me personat që janë -- që kanë qenë pjesë e asaj teme.
Py. Me sa ju kujtohet, a mund të na jepni emrat e këtyre personave?
Pë. Nuk e di për cilin rast po flisni se ka pasë shumë tema që kam bërë.
Py. Po e bëj ndryshe pyetjen. Z. Berisha, ke qenë i pranishëm në konferencën për shtyp të dhënë nga OVL UÇK-ja në 7 shtator 2020?
Pë. [E padëgjueshme].
Py. Ku u mbajt kjo konferencë për shtyp?
Pë. Në zyrat e OVL UÇK-së.
Py. Ku ndodhet kjo zyrë?
Pë. Kjo zyrë ndodhet në afërsi të Komunës së Prishtinës.
Py. Nga e more vesh për këtë konferencën?
Pë. Lajmëruan mediat që ka me pasë një konferencë.
Py. Z. Berisha, në atë kohë ti ke punuar me median. E ke dëgjuar, e dëgjove, a e lexove, si e more vesh?
Pë. Për konferencën në fjalë apo?
Py. Po. Atë të mbajtur në 7 shtator 2020.
Pë. Unë isha në mbledhjen e mëngjesit që e mbajmë çdo ditë edhe aty një prej gazetarëve ka tregu që ka mundësi OVL UÇK ka mundësi me thirr një konferencë për media. Pastaj jam interesuar edhe ka dalë njoftimi që ka me u thirr një

konferencë për mediat ku dhe kam marrë pjesë.

Py. Në qoftë se ju kuptova drejt dikush në zyrë të tha që do të mbahej një konferencë?

Pë. Ka thënë që pas disa informatave që i ka, mundet me qenë një konferencë për media.

Py. Pasi more këtë informacion, e kontaktove OVL UÇK-në përpara konferencës për shtyp?

Pë. Po.

Py. Me kë kontaktove?

Pë. Me Nasim Haradinajn.

Py. E kishe njohur më parë z. Haradinaj?

Pë. Si gazetar kam njoft shumë njerëz që kanë qenë pjesë e organizatave ose institucioneve. Në këtë rast edhe z. Haradinaj.

Py. Përse konkretisht kontaktove z. Haradinaj?

Pë. Gjithmonë ka qenë më i qasshëm për mediat.

Py. Kur e kontaktove z. Haradinaj, çfarë pyetje i bëre? Për çfarë e pyete?

Pë. Nuk është që më kujtohet saktësisht. Megjithatë, me aq sa më kujtohet, e kam pyetur që kemi informata që ka me u mbajt një konferencë për media dhe a është e vërtetë që ka me u mbajt një konferencë e tillë.

Py. E çfarë ju përgjigj ai?

Pë. Më ka thënë që shpejt kanë me dalë me një njoftim publik ku kanë me tregu nëse ka diçka edhe që, nëse ka, atëherë

mundna me marr pjesë.
Py. Pasi mbaruat bisedën me z. Haradinaj, çfarë bëtë pastaj?
Pë. Pastaj kemi vazhduar punë të tjera në zyrë që i kemi dhe me tema tjera. Derisa e kam pa, nëse nuk gaboj, ka qenë njoftimi publik për konferencën në fjalë.
Py. Kur mbërritët në OVL UÇK, a patë gazetarë të tjerë aty të pranishëm përveç vetes?
Pë. Në fakt, unë kam mbërri shumë herët atje dhe në fillim kur kam mbërri unë, nuk ka qenë asnjë gazetar aty.
Py. Gjatë konferencës për shtyp, si mendon sa gazetarë mund të ishin, maksimumi sa gazetarë mund të kishte të pranishëm?
Pë. Mendoj që dikun rreth 10 gazetarë, po nuk jam i sigurt.
Py. E kuptoj. A të kujtohet se çfarë organesh të shtypit ishin të pranishëm përveç gazetës InFokus?
Pë. Me aq sa mbaj mend, po që prapë nuk jam shumë i sigurt, ka qenë Kosova Press, ka qenë Ekonomia Online, më duket që ka qenë edhe një ekip i kallxo.com, po nuk jam shumë i sigurt. Nuk e di për të tjerat.
Py. Si filloi konferenca për shtyp?
Pë. Kemi pritë ato për disa minuta në zyrë, pastaj kanë ardhur personat që e kanë mbajtur konferencën për media dhe kanë filluar konferencën.
Py. Kush foli në konferencën për shtyp?
Pë. Ashtu siç shihet dhe në video, që është e dhënë edhe online, kanë fol z. Nasim Haradinaj dhe z. Hysni Gucati.

Py. Dhe për çfarë folën ata në konferencë?
Pë. Për disa dokumente të cilat i ka sjellë në zyrën e OVL-së një person i panjohur.
Py. Çfarë thanë tjetër ata lidhur me dokumentet?
Pë. Ka tregu që papritur, nuk e kanë ditë që ka me i sjellë dikush dokumentet, i ka sjellë dikush dokumentet në mëngjes edhe ato dokumente po i prezantojnë në konferencë për media.
Py. Me çfarë kishin të bënin dokumentet?
Pë. Në konferencë për mediat dokumentet thuhej se ishin prej Gjykatës Speciale.
Py. Tani, z. dëshmitar, juve përmendët një video të kësaj ngjarjeje. Tani dua që t'ju tregoj pjesë të caktuara të kësaj videoje.

Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, të nderuar Gjykatës është një video që i është caktuar numri P1. Videoja është pjesë e provës materiale. Ndërkohë unë dua që ju të shikoni nga minuta e 14, për 30 sekonda deri në minutën 16 në këtë video. Nuk do transmetohet zëri por thjesht unë jam më shumë i interesuar për të parë se çfarë po bën personi që kemi përpara, ndërkohë që në faqet e transkriptit, faqet në anglisht dhe në shqip janë nga faqja 6 në faqen 8.

Dhe do t'ju kërkonim të nderuar Gjykatës që të kalojmë në seancë private për dy minuta. Në mënyrë që të mund të shfaqim këtë segment.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Për arsye

të mbrojtjes së konfidencialitetit, do të kalojmë në seancë private.

Znj. Sekretare.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SHOQËRUESJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi serish në seancë publike.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Z. Berisha, lidhur me segmentin e videos që neve treguam në seancë private, a ishte kjo konferenca në të cilën keni marrë pjesë juve?

Pë. Po.

Py. Ju lutem, identifikoni personat që juve patë në ekran gjatë transmetimit të videos?
Pë. Z. Nasim Haradinaj dhe z. Hysni Gucati.
Py. A e dini emrin e personit të tretë?
Pë. Nuk e di.
Py. Ju lutem, përshkruani se çfarë po bënin z. Gucati dhe z. Haradinaj në atë segmentin e videos që u transmetua për ju?
Pë. Po kërkonin disa dokumente të cilat thuhet që dëshmojnë bashkëpunimin që e ka pasur Task Forca Speciale e Hetimit me prokuror edhe njerëz të institucioneve të Serbisë.
Py. Z. Berisha, pas konferencës për shtyp, pasi mbaroi konferenca për shtyp, çfarë bënë z. Gucati dhe z. Haradinaj lidhur me dokumentet që po diskutonin?
Pë. Kur konferenca për shtyp u shpall e mbyllur gazetarët edhe kameramanët, sikur në çdo konferencë tjetër ku paraqiten dokumentet, janë afruar dhe kanë filluar me fotografu ose me i xhiru dokumente për shkak të pamjeve që ju kanë nevojit. A kërkuat juve të merrnit një kopje të dokumentit?
Pë. Pasi numri i dokumenteve ishte goxha i madh edhe nuk kish mundësi që, nuk e dijshim edhe saktë se çka mundet me pasë aty, nuk kish pasë mundësi edhe me i xhiru krejt edhe, kështu kam kërkuar një pjesë të dokumenteve.
Py. Kë kërkuat për një kopje?
Pë. Isha aty afër bashkë me të gjithë gazetarët edhe personat që e kanë udhëheq konferencën edhe ato veç kam pyetur se a muj

me i marrë një pjesë të dokumenteve.
Py. Kur po thoshe "personat që drejtuan konferencën" për kë persona e ke specifikisht, kujt ju kërkua specifikisht që t'ju jepnin dokumentet?
Pë. Unë aty bana pyetje nëse muj me i marr dokumentet. Nuk është që u drejtova dikujt specifikisht, po aty ishin personat që e udhëhoqën konferencën edhe në drejtim tyre e bëna pyetjen.
Py. Kur thua që ju "atyre të gjithëve" e keni fjalën për z. Gucati dhe z. Haradinaj?
Pë. [E padëgjueshme].
Py. Çfarë të thanë ty ata në përgjigje të pyetjes që u bë, pra, në qoftë se mund t'i merrni dokumentet apo jo?
Pë. Po, mu lejua që me i marrë dokumentet.
Py. A e mend se kush t'i tha fjalët "se mund t'i marrësh dokumentet" ndërmjet të dyve, kush t'i tha këto fjalë?
Pë. Z. Nasim Haradinaj.
Py. Sa faqe keni marrë afërsisht?
Pë. Është problem me e ditur. Që ka qenë numër i madh, megjithatë mendoj, që dikun rreth 1000 faqe ndoshta.
Py. Z. Berisha, pasi i morët faqet tuaja a kishte paketa të tjera informacioni që mbetën aty në sallë, ndërkohë që ti i more dokumentet që more?
Pë. Po sa e di unë ka pasë edhe tjera aty.
Py. A ka parë ndonjë person tjetër që ka marrë dokumente

ndërkohë që ti ishe aty?

Pë. [E padëgjueshme] -- dikën tjetër pasi që posa i kam marrë dokumentet kam dalë prej asaj zyrës ku është mbajtur konferenca.

Py. Kur z. Haradinaj të dha leje që të merrje dokumentet atë tha ndonjë gjë tjetër lidhur me këto dokumente të tha ty ai ndonjë gjë tjetër lidhur me to?

Pë. Kontakti ka qenë shumë i shkurtë. Unë veç kur i kam marrë dokumentet. Ato kanë qenë një numër i madh i tyne, siç e ceka ma herët edhe ka qenë problemi me i pasë të gjitha me i mbajtë në dorë, kështu që, kam kërkuar një diçka që më i fut dokumentet një qese. Ose diçka të tillë.

Py. A tu tha ty gjë lidhur me fotokopjimin e dokumenteve?

Pë. Jo. Megjithatë, më është thënë që përderisa ka shumë dokumente numri i kopjeve që janë ato është i vogël dhe nuk ka për të gjitha mediat. Kështu që, nëse mundet me i kërku ndonjë media tjetër, për shkak që mos me i pasë veç unë, nëse është e mundshme që me bashkëpunu edhe me ta me mediat tjera.

Py. Çfarë donte me thënë "me bashkëpunu me media të tjera se nuk kishte shumë kopje" na e shpjego pak këtë?

Pë. Po thashë edhe ma herët, që aty ka pasë shumë media dhe nuk ka pasë kopje për të gjitha mediat. Kështu që, kur unë e kam ba kërkesën që me i pasë dokumentet dhe që mu kanë dhënë këto dokumente. Mediat tjera kanë mbetur pa dokumente të tilla dhe më është thënë që nëse dikush prej mediave i kërkon,

atëherë me ju ndihmu edhe atyre.

Py. Domethënë, me fjalë të tjera, juve ju kërkua që të bëni kopje për përfaqësuesit e tjerë të medias; apo jo?

Pë. [E padëgjueshme] -- kush atëherë me i shpërnda me ta po.

Py. Kush ta tha ty këtë gjë? Pra kush ta tha ty që t'ia jepje këto dokumente ose t'i shpërndaje këto dokumente për përfaqësues të tjerë të medias?

Pë. [E padëgjueshme] – ba pyetjen për me i marrë dokumentet, më është përgjigj z. Nasim Haradinaj dhe me të e kam vazhduar bisedën.

Py. Sa për të qenë i qartë, pra, fakti që në qoftë se gazetarët e tjerë do të donin të kishin kopje të këtyre dokumenteve ju duhet t'i ndani me ta, këtë koment e ka bërë z. Haradinaj; apo jo?

Pë. [E padëgjueshme].

Py. Z. Berisha, kur u largove nga konferenca për shtyp së bashku me këto dokumente ju lutem na përshkruani se çfarë bëtë pas kësaj?

Pë. [E padëgjueshme] -- ku kam pasë me shku është diku, nëse nuk gaboj, rreth 1 kilometër e gjysëm ose 2 kilometra larg. Edhe kështu, tuj e pasë parasysh që kam një numër të madh dokumenteve, kam mëndu që mundet me ardhë dikush prej zyrës që me më marrë me veturë.

Në atë moment, më është deshtë me prit. Edhe e kam pi një kafe në bufenë e OVL UÇK-së, në një bufe afër aty që është në

objekt.
Py. Në çfarë pike pas konferencës për shtyp, së pari i patë ose i inspektuat dokumentet që ju dhanë në konferencën për shtyp?
Pë. Më fal, nuk e kuptova pyetjen?
Py. Në çfarë pike pasi u organizua konferenca për shtyp ti i inspektove dokumentet që more nga konferenca për shtyp.
Pë. [E padëgjueshme] -- të gazetës inFokus.
Py. Kur i inspektuat dokumentet, çfarë patë aty?
Pë. Ka qenë problem se, siç e thashë, numri i tyre ka qenë shumë goxha i madh dhe kanë qenë renditja e tyre ka qenë çrregullt. Kështu që pak a shumë ka qenë problematike edhe me e kuptu, në fakt, se çka saktësisht ka aty.
Py. A patët mundësi që të vlerësoni klasifikimin e këtyre dokumenteve?
Pë. Si gazetar, me ditë nëse dokumentet janë konfidenciale ose jo, se nuk kam ndonjë mjet që mund me e vlerësuar këtë punë. Megjithatë, në disa prej faqeve, në disa prej dokumenteve ka qenë shkrimi që tregon që janë të klasifikuara konfidenciale.
Py. Sa kohë më përpara kishit që i shikonit dokumentet përpara sesa t'u vinte në sy ky klasifikim?

Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta do të ishte mirë që të riperifrazohet pyetja duke përdorura fjalët e përdorura nga dëshmitari sepse ai tha "shenja klasifikim".

Z. HALLING: [Përkthim] Po do ta bëj këtë gjë. Jam i lumtur ta bëj këtë gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E pranoj. Nuk e di në qoftë se ishte kundërshtim ose në qoftë se ishte kërkesë për qartësim.

Z. HALLING: [Përkthim] Do ta bëj këtë gjë.

Py. Z. dëshmitar, na thatë që në disa prej faqeve kishte një shënim "konfidencial" a e mbani mend sesa kohë kishte që i shikonit dokumentet përpara sesa t'i vinit re këto shënime?

Pë. Nuk e di. Se, në fakt, ka qenë njëherë derisa i kemi marrë, i kemi shpërnda dokumentet aty në zyrë, që me i shiku në fakt se çka ka, po besoj diku ndoshta mbas gjysmë ore 45 minuta ndoshta.

Py. Pra, kur e kuptuat që kishte shenja konfidenciale, ishte ky shënimi konfidencial në këto dokumente, çfarë bëtë më pas?

Pë. [E padëgjueshme] -- kemi pasë dyshime edhe për autenticitetin e dokumenteve po ashtu edhe për konfidencialitetin e tyre. Se në atë -- pastaj kemi marrë dokumentet i kemi shkruar edhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar një email për me pyet për këto dokumente. Po që përgjigja ka qenë, në fakt, pa përgjigje kanë thanë që: nuk mujna me i komentu këto gjëra.

Në atë rast tuj qenë të dyshimtë, tu dyshu që këto dokumente edhe për autenticitetin e tyre edhe për konfidencialitetin, kemi vendos që me i ruaj këto dokumente

edhe mos me u marrë shumë me to derisa që qartësohet pak më shumë.

Py. Kur thatë që "mos me i trajtu, mos me u marrë me këto dokumente" çfarë bëtë, domethënë, i ruajtët, i futët diku në një vend të sigurt?

Pë. [E padëgjueshme] -- disa shkrime për dokumentet. Disa shkrime që jemi kujdes për ato që të paktën ka shkru "konfedencial" edhe pse kemi pasë dyshime se a janë ma së pari autentike prej adresës ku thuhet që kanë ardhur dhe a janë konfidenciale. Jemi kujdes që ato mos me i publiku. Ndërsa dokumentet në fjalë i kemi vendosë në atë hapësirën ma të sigurt që mundet me qenë në gazetën inFokus.

Py. Ku ishte? Kush ishte ky vendi që ishte më i sigurt në ambientet e inFokusit?

Pë. [E padëgjueshme] -- ku qëndrojnë, në zyrën ku qëndrojnë drejtori dhe administrata edhe ku janë edhe dokumentet që -- dokumentet financiare të financave të kompanisë. Aty është vendi më i sigurt që ashtë në gazetën inFokus. Nuk kemi ndonjë vend të veçantë për dokumente të rëndësishme.

Py. Kur janë ruajtur tek zyra e drejtorit, kush ka pasur qasje në këto dokumente?

Pë. Gazeta inFokus është një media që funksionon me një zyrë të madhe, një zyrë të madhe ku janë gazetarët, një zyrë e takimeve edhe zyrën e drejtorit. Kështu që aty, gjithmonë, kur janë gazetarët aty me siguri është edhe dikush prej

administratës dhe drejtorit. Kështu që gjithçka aty është e hapur për të tri palët, po mendoj për gazetarët, për redaktorët edhe për drejtorin. Po zakonisht, në zyrën ku është drejtori nuk futen gazetarët ose punëtorët e tjerë pa qenë dikush brenda.

Py. Mesa e dini më së miri ju, gjatë kohës që këto materiale ishin në posedim të gazetës inFokus, a është heq apo shtuar diçka në ato materiale, pra, me sa dini ju?

Pë. Me aq sa e di unë, në ato materiale as nuk është shtu as nuk është heq asnjë dokument.

Py. Z. dëshmitar, ndoshta tashmë na e thatë njëherë por për ta konfirmuar a e kontaktuat Zyrën e Prokurorit të Specializuar për t'i informua ata se i keni këto dokumente?

Pë. Sa më kujtohet, kemi pasur -- i kemi shkruar dy herë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Po ata kanë qenë të njoftuar për dokumentet që i posedojmë. E fillimisht i kemi pyetur për këto dokumente se a janë prej adresës që shkruhet që janë. Edhe a janë në dijeni ata për këto dokumente.

Py. Z. Berisha, gjatë kohës që i kishit këto faqe ju në gazetën inFokus apo më pas, gazeta inFokus a i ka marrë këto dokumente prej ndonjë burimi tjetër?

Pë. Jo, aq sa di unë nuk ka pasur ndonjë burim tjetër për këto dokumente.

Py. Z. dëshmitar, ju përmendët dy shkëmbime me email me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Z. HALLING: [Përkthim] Tani do t'ua tregoj njërin prej tyre. Është dokumenti me numër P98 MFI. Dhe faqet janë 091915 deri në faqen 091916.

Tani nuk e di në qoftë se z. Koci ka kopje të këtyre emaileve që do t'ia tregoj dëshmitarit. Unë kam kopje të shtypur të të gjitha provave që do t'i përdorim me dëshmitarin dhe mund t'ia jap lirisht një kopje avokatit të dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Koci, a ju duhet kopje e këtyre dokumenteve?

Z. KOCI: [E padëgjueshme].

Z. HALLING: [Përkthim] Me ndihmën e Sekretares këto dokumente do t'ju jepen dhe Mbrojtja është e mirëseardhur që t'i shikoj këto dokumente. Janë thjesht kopje të provave nga lista e provave që do të përdorë Prokuroria.

Z. REES: [Përkthim] Brenda kësaj dosje ka dhe disa artikuj të cilat për aq sa mund të gjykojmë ne nuk lidhen me këtë dëshmitar. Këto janë kopje të Shënimeve Zyrtare të përpiluara nga një oficer i sigurisë operative, nga znj. Pumper që dha dëshmi sot në mëngjes. Dhe ka një Shënim Zyrtar tjetër si edhe deklarata e znj. Pumper së bashku me Notën zyrtare të oficerit të sigurisë operative.

Nuk e di sepse këto dokumente janë përfshirë në dosjen e dokumenteve që do t'i paraqiten këtij dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë mendova që do të flasim për disa emaile. Por kjo është një

diçka tjetër.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtë që ia dhamë tani Mbrojtjes së z. Gucati është vetëm riprodhim i dokumenteve në listën e provave por në kopje të shtypur. Thjesht, duam që këtij dëshmitari t'ia tregojmë vetëm ato faqe që i ka shënuar ai vetë.

Z. REES: [Përkthim] Faleminderit për qartësimin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju faleminderit. Tregojani këto edhe z. Koci.

Z. HALLING: [Përkthim] Për dëshmitarin ai mund t'i shikojë këto dokumente në ekran. Janë dokumentet me numër P98 MFI deri në faqen 091915.

Ndërsa për z. Koci që mund të na ndjekë është nënndarja numër 2.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Koci, është prova me numër 325.

Z. HALLING: [Përkthim] Dhe numri i faqes është 091915.

Do të pres që z. Koci të orientohet në dosje dhe pastaj do të vazhdoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në rregull?

Tani mund të vazhdoni z. Halling.

Z. HALLING: [Përkthim]

Py. Z. Berisha, a e keni të njohur këtë email që e shikoni në ekran?

Pë. [E padëgjueshme].
Py. A është ky një prej dy emaileve që ja dërguat Zyrës së Prokurorit të Specializuar?
Pë. Kjo është një prej dy emaileve që i kam dërguar Zyrës së Prokurorit të Specializuar e për të cilat emaile kemi vendos si redaksi me i dërgu.
Py. Faleminderit.
Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani të kalojmë tek faqja në vijim.
Py. Aty është nënshkrimi juaj; apo jo?
Pë. [E padëgjueshme] -- edhe pozita në gazetën inFokus.
Z. HALLING: [Përkthim] Dhe po qe se do të shkonim në faqen tjetër me numër 091917.
Py. Z. Berisha, këtë email e keni të njohur, e njihni?
Pë. Po.
Py. A e keni shkuar këtë email ju Zyrës së Prokurorit të Specializuar?
Pë. Unë e kam dërguar këtë email prej emailadresës teme, megjithatë, kemi shkruar bashkë me -- e kemi përpiluar, e kemi shkruar bashkë me redaksinë.
Py. Dhe pse e keni dërguar këtë email?
Pë. Këtë email e kemi dërguar për arsye që, siç thamë ma herët, përgjigja e parë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në fakt, nuk e di a mujna me çu përgjigje se nuk kanë thanë kurrfarë informate. Veç na kanë thënë që nuk mujna me fol për

këtë temë.

Edhe, siç e ceka ma herët, kemi qenë -- nuk jemi kanë të sigurt së pari për autenticitetin e dokumenteve pastaj edhe për konfidencialitetin e tyre. Edhe kemi dëshiru me shku në mënyrë të sigurt edhe e kemi njoftuar edhe Prokurorinë, Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Py. Sikurse thuhet në email:

"I kemi mbyllur me çelës dokumentet në një vend të sigurt dhe dua t'ju informojmë për këtë".

A është kjo pjesë për të cilën na folët më herët, domethënë, vendi ku i keni mbajtur, ku i keni ruajtur këto dokumente?

Pë. Po.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë moment propozojmë që shenja MFI të hiqet nga dokumenti P98 në lidhje me tre faqet që u vërtetuan, u konfirmuan nga dëshmitari.

Për mendimin tonë, kjo pjesë mund të pranohet si pjesë e provës materiale me një shtesë të numrit si p.sh., P98.1 ose këtyre tre faqeve t'ju jepet një numër i veçantë i provës. Se ne tani këto tre faqe do t'i paraqesim si prova materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A ka kundërshtim Mbrojtja?

Z. REES: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim. [Nuk ka

mikrofon].

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë kësaj do t’ia vëmë numrin P98.1, pra, nuk do të përdorim shkurtesën MFI në fund. Dhe pranohet si provë.

Z. HALLING: [Përkthim] Edhe pse dokumenti P98 MFI është i klasifikuar si konfidencial, dokumenti P98.1, sikurse e përshkruat ju, mund të jetë publik.

Z. REES: [Përkthim] Vetëm të kontrolloj njëherë. Provat me numrin ERN 091915 deri në 091916 tani kanë numrin P98.1 apo jo?

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

A ka ndonjë kundërshtim nga palët në lidhje me klasifikimin publik të dokumentit.

Z. REES: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë dokumenti riklasifikohet si publik.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

Py. Z. Berisha, Zyra e Prokurorit të Specializuar a erdhi për t’i marrë dokumentet që i diskutuam?

Pë. Po, kanë ardhur dy hetues, që janë paraqit si hetues të Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Py. Dhe kjo ndodhi më 9 shtator 2020, a është e saktë?

Pë. Me aq sa më kujtohet, po.

Py. Ju lutem, na e përshkruani ndërveprimin, kontaktin që kishit me përfaqësuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kur ata erdhën për t'i marrë dokumentet?

Pë. Fillimisht më ka thirrur dikush prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar, një numër që ka qenë prej Holandës, dhe më ka pyet nëse munden dy hetues me ardhë dhe me i marrë dokumentet. Unë e kam pranuar që ata me ardhë. Pastaj ata më kanë thirrë në telefon, e kemi lanë takimin, se nuk e kanë ditë saktë se ku është zyra. Kanë ardhë në zyrë, kanë qëndruar për, nëse nuk gaboj, një orë, rreth një orë. Para se ata me i pa dokumentet, ja u kemi kërkuar një kartelë identifikimi, që me e ditë sigurt nëse janë ata personat që janë prezantu. Na kanë prezantu kartelat e identifikimit që kanë qenë prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Na kanë kërkuar që së pari me i pa dokumentet. I kemi marrë dokumentet prej atij vendit ku i kemi vendos. I kanë pa dokumentet dhe na kanë kërkuar që me i marrë dokumentet. Pastaj kanë marrë dokumentet dhe kanë shku.

Py. Përfaqësuesit e ZPS-së, ai morën të gjitha dokumentet që ju i kishit marrë nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së.

Pë. [E padëgjueshme] -- i morën të gjitha dokumentet që i kemi pasë, që i kemi marrë.

Py. A dihej publikisht, a u bë e njohur publikisht se gazeta inFokus ja kishte kthyer këto dokumente Zyrës së Prokurorit të

Specializuar?
Pë. Po, është bërë publike që hetues të Zyrës së Prokurorit të Specializuar kanë ardhur dhe i kanë marrë dokumentet.
Py. A reagoi dikush prej OVL UÇK-së ndaj asaj që ju ja kishit kthyer këto materiale Zyrës së Prokurorit të Specializuar?
Pë. Askush prej Organizatës së Veteranëve të Luftës nuk më ka thirrë në telefon, as nuk kemi pasur ndonjë kontakt në lidhje me këtë punë.
Py. Po dikush prej OVL UÇK-së a ka bë ndonjë koment publik lidhur me këtë?
Pë. Lidhur me që i kanë marrë dokumentet apo?
Py. Po. Lidhur me faktin që ja keni dhënë dokumentet Zyrës së Prokurorit të Specializuar?
Pë. Nuk më kujtohet nëse dikush ka pasur ndonjë koment në lidhje me ato që na kanë marrë dokumentet.
Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari posa tha se nuk i kujtohet. Me lejen tuaj dua që dëshmitarit t'ia tregoj faqen 20 të pjesës së parë të intervistës së tij me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, faqja është e transkriptit në anglisht. Dhe bëhet fjalë për rreshtat 18 deri në 25.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, mund ta bëni këtë.
Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.
Z. Koci, për ju, për t'ju orientuar është nënndarja 496

dhe dokumenti ka numrin ERN 102781-TR-ET, Pjesa 1, E Rishikuar.

Py. Z. Berisha, do t'ju lexoj një pyetje dhe një përgjigje që keni dhënë ju nga intervista juaj me ZPS-në në gusht dhe pastaj do t'ju pyes pyetje.

"Py. Pra, kishte programe televizive ku përfaqësues të OVL UÇK-së thanë çfarë?"

"Pra, këta përfaqësues të OVL UÇK-së kanë thënë në këto programe televizive se këto dokumente të kishin qenë në lidhje me OVL UÇK-në atëherë gazetarët padyshim që do ta bënin të ditur këtë informacion. Mirëpo kjo nuk ndodhi. Asnjëri nga gazetarët nuk publikoi këto dokumente në këtë rast.

Z. dëshmitar, a është kjo një deklaratë e saktë e asaj që keni thënë ju, kjo që jua lexova?

Pë. [E padëgjueshme] A ishte pyetja nëse kam thënë këtë deklaratë unë apo?

Py. Pyetja ime është ajo që ua lexova, a jua rikujtoj pak në lidhje me atë në qoftë se ishin bë komente publike prej përfaqësuesve të OVL UÇK-së?

Pë. Po. Po kjo nuk është përgjigjja në pyetjen që m'u parashtruar. Dhe pyetja që mu parashtruar ishte nëse ka pasë reagime që i kam dorëzuar -- që i kemi dorëzuar dokumentet. Ndërsa këtu nuk është përgjigja në lidhje me atë pyetje.

Këtu unë kam thënë që ka pasë reagime nëpër emisione televizive për mospublikimin e dokumenteve jo për dorëzimin e

dokumenteve.

Py. Domethënë, në këtë koment publik përfaqësuesit e OVL UÇK-së e kritikojnë gazetën inFokus që nuk i ka publiku këto materiale; a është kjo e saktë?

Pë. Jo, nuk e kam kuptuar kështu. Unë nuk e kam kuptuar që këta e kanë kritiku gazetën inFokus. Unë mendoj që çështja ka qenë për krejt gazetarët jo e dedikuar për gazetën inFokus ose për mu.

Py. Z. dëshmitar, a i kuptuat ju deklaratat e tilla si diçka që i referoheshe edhe vetë gazetës inFokus?

Pë. Na kemi qenë të hapur prej momentit që kemi marrë dokumentet. Kështu që ka qenë publikisht e ditur që na i posedojmë dokumentet. Përderisa janë bërë këto komente edhe pse kanë qenë në përgjithësi për gazetarët, na jemi gazetarë dhe jemi media. Kështu që edhe na jemi pjesë e tyre.

Py. E kam të qartë këtë. Mirëpo nga deklarata juaj, unë e kuptova se kjo ishte një farë komenti për faktin se disa media nuk i publikonin materialet. Mesa e kuptoni ju, ky koment nga intervista në lidhje me gazetën inFokus, a e kuptoni diçka si të drejtuar edhe ndaj vetë faktit që nuk i ka publiku këto gazeta inFokus.

Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk e dimë se për çfarë deklarate flet Prokurori.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju e pyetni atë që të hamendësoj për diçka që ai jo domosdoshmërish

e di.

Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja ime ka të bëjë në qoftë se dëshmitari e ka kuptuar atë koment si diçka që i është referuar edhe vetë medias ku ka punuar ai.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Atëherë mund ta kem edhe unë gabim. Kjo pyetje nuk provon asnjë gjë.

Z. HALLING: [Përkthim]

Py. Dëshmitar, ju thatë se ZPS-ja apo Zyra e Prokurorit të Specializuar erdhi për të marrë dokumentet nga gazeta inFokus. Dhe tani do t'jua tregoj një dokument.

Z. HALLING: [Përkthim] Është me numrin P100 MFI. Është në dosjen e materialeve në nënndarjen 2.

Py. Z. Berisha, a e shikoni emrin tuaj në këtë faqe?
Pë. Po.
Py. Dhe a është ai nënshkrimi juaj?
Pë. [E padëgjueshme].
Py. Çfarë dokumenti është ky?
Pë. Ky është dokument që na u është ofruar prej hetuesve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar pasi i kanë marrë dokumentet që me e nënshkru na për këtë dorëzimin e dokumenteve që i kanë marrë ata.
Py. Z. Berisha, ku thuhet përmbajtja, aty shkruhen fjalët "dokumente nga OVL UÇK-ja, a e shikoni këtë?
Pë. Po.
Py. Dhe kjo ju referohet dosjeve të cilat ju ua dorëzuat

përfaqësuesve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar; a është kjo e saktë?

Pë. Po. Kjo është për dosjet që hetuesit i kanë marrë prej gazetës inFokus.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë moment ZPS-ja propozon që ta heqë përcaktimin MFI dhe t'a paraqesë si provë materiale P100.

Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon] Pra, pranohet P100.

Z. HALLING: [Përkthim] Lidhur me klasifikimin e provës, kjo provë është e klasifikuar aktualisht si konfidenciale për të mbrojtur identitetin e personelit të ZPS-së, 04876. Kërkesa e këtij dëshmitari për t'u quajt -- për t'u futur në listën e dëshmitarëve nuk është vendosur akoma pritet të vendoset. Në qoftë se miratohet atëherë do ta riklasifikojmë këtë provë si publike.

Py. Z. Berisha, ke marrë pjesë në ndonjë konferencë tjetër të shtypit në shtator 2020 të organizuar nga OVL UÇK-ja?

Pë. [E padëgjueshme] -- në ato ditë -- në atë ditën ku janë ba arrestimet, në konferenca tjera nuk kam marrë pjesë.

Py. Po ndonjë njeri tjetër nga gazeta përpara arresteve, kanë marrë pjesë në këto konferenca për shtyp?

Pë. Unë nuk kam marrë pjesë në asnjë konferencë për shtyp

tjetër. Ndërsa prej personave të tjerë të gazetës inFokus, aq sa di unë, aq sa kam informatë, nuk ka marrë pjesë kërrkush.

Py. [Nuk ka përkthim].

Pë. Sepse është -- sepse gazeta inFokus nuk është një media me shumë gazetarë edhe kryesisht punojmë prej zyrës. Kështu që në këto konfere -- e kemi përcjellë konferencën e parë dhe nuk kemi -- edhe kemi vendos që të mos me shku në konferenca tjera. Nuk e kemi pa të arsyeshme me marrë pjesë.

Py. Z. Berisha, në cilësinë tende si gazetar, ke shkruar artikuj në shtyp lidhur me këto konferencat e shtypit të OVL UÇK-së në shtator 2020?

Pë. Po.

Py. Sa artikuj, afërsisht, ke shkruajtur?

Pë. Është shumë problem me dhënë një numër të caktuar sepse brenda ditës nuk jemi marrë veç me një temë, po zakonisht, brenda ditës unë, personalisht, i kam shkruar dikun rreth 30 deri 40 ose dhe ma shumë artikuj. Kështu që është problem me mbajte mend një numër të caktuar.

Py. Kur thua 30, 40 artikuj për tema të ndryshme, a ishin këto të lidhura me aktivitetet, me veprimtarinë e organizatës së të OVL UÇK-së në shtator të 2020?

Pë. Jo, domosdoshmërish. Kemi përcjellë shumë aktivitete shumë ngjarje dhe jemi marrë me shumë tema njëkohësisht.

Py. A mund të më thuash afërsisht sesa artikuj ke shkruar atë muaj, konkretisht, për OVL UÇK-në?

Pë. Është prapë shumë vështirë me përcaktuar sesa kam shkruar se, siç thashë, rreth 40 ose më shumë kam shkruar brenda ditës. Po nëse veç -- s'kisha thanë që kam shkruar ma shumë se 10 artikuj gjatë krejt muajit. Po nuk e di sigurt, mundet me ndryshuar numri.

Py. Duke u përqendruar te artikujt e ndryshëm që keni shkruar, keni publikuar ndonjë artikull lidhur me ato dokumente që morët u personalisht?

Pë. Po.

Py. Kur i keni publikuar këto artikuj lidhur me materialet që kishit marrë, në atë kohë materiale ishin ende në posedimin tuaj?

Pë. Aq sa më kujtohet edhe jam goxha i sigurt, që tekstet, artikujt që i kemi shkruar për dokumentet kanë qenë veç gjatë kohës që i kemi poseduar. Pas kësaj na kemi vazhduar me shkru për këtë punë por nuk kemi shkruar për dokumente specifike pas që nuk i kemi pasur.

Py. Këto artikuj për të cilët po flasim tani, a përfshinin dhe fotografi të këtyre dokumenteve që i morët nga OVL UÇK-ja?

Pë. Disa prej tyre, po. Po jemi kujdes që, prapë po e përsëris, edhe pse nuk i kemi ditë nëse këto janë autentike dhe nëse janë konfidenciale jemi kujdes që në ato pjesë ku mundet me qenë na një informatë e ndjeshme me e editu, me e fsheh, mos me e publiku.

Py. Z. dëshmitar, do t'ju tregoj një numër artikujsh të

medias.

Do të bëjmë sa më shumë që të mundemi deri në orën 16.00 dhe pastaj do vazhdojmë nesër.

Do t'ju pyes lidhur me këta artikuj, nëse e keni shkruar ju, për çfarë bëhet fjalë dhe për ato që ju i keni shkruar të na shpjegoni pa nxjerrë burimet konfidenciale sesi i mësuat ato që kemi shkruar.

Z. HALLING: [Përkthim] Dua ta filloj me artikullin P125 MFI, faqet 081361 deri 081362. Është nënndarja 40 në listën e provave materiale numri është 40. Në transkriptin në anglisht është nënndarja 39 dhe ka të njëjtën ERN me ET në fund.

Py. E shikoni këtë artikull?
Pë. Ashtu siç po shkruan te autori emri jem. Unë jam edhe autori i këtij teksti, i cili më pas është redaktuar prej redaksisë së inFokusit para se me u publiku.
Py. Kur u shkrua? Kur është shkruar?
Pë. Është problem me dhënë një datë, një kohë të saktë. Mirëpo, zakonisht tekstet që i publikojmë janë shkruara brenda asaj ditës. Kështu që këtu po shkruan më 7 shtator. Me siguri që ka qenë atë ditë.
Py. Faleminderit. Z. dëshmitar, në këtë faqe dua të të lexoj një pjesë të transkriptit në anglisht. Thotë:

"Gazeta inFokus ka siguruar të dhëna me anë të të cilës Forcat Speciale Hetimore në kuadër të Speciales kanë kërkuar dëshmi e fakte në Serbi".

Z. Berisha, kjo fjali ka të bëjë me materialet që keni marrë nga OVL UÇK-ja?

Pë. Po, kjo është një prej dokumenteve që kanë qenë pjesë e dosjes.

Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim, ju lutem, faqen tjetër.

Py. Çfarë përshkruan kjo fotografi, a mund të na i thoni?

Pë. Kjo fotografi është një fotografi e atij dokumentit i cili flet për këtë tekstin që e kemi shkruar edhe prej të cilit i kemi fsheh disa të dhëna që kanë mujt me qenë ndoshta të ndjeshme.

Py. Pra, në qoftë se nuk e kam gabim, është një fotografi e një prej dokumenteve që keni marrë në OVL UÇK?

Pë. Po.

Z. HALLING: [Përkthim] Tani dua të shohim dokumentin tjetër 081364 deri te 081367. Është në të njëjtën grup dokumentesh MF 125 [sipas përkthimit]. Por transkripti në anglisht ka në fund ET të numrit ERN që sapo lexova dhe gjendet në nënndarjen 41.

Py. Z. dëshmitar, a e shikoni këtë artikull?

Pë. Po.

Py. E shkruajte ti këtë?

Pë. Po, sikur te artikulli tjetër autori është emri im dhe është i redaktuar prej redaksisë së inFokusit.

Py. [Nuk ka përkthim].

Pë. Këto janë dokumentet --

Py. Përshkruaj këto që shikon këtu?
Pë. -- që i kemi marrë edhe pasi jemi kthyer në zyrë -- ky ka qenë, me sa kujtoj, numri total i dokumenteve. Nuk jam i sigurt. Edhe pasi jemi kthyer në zyrë i kemi bërë një fotografi tyre dokumenteve që i kemi marrë.
Py. Pra, nuk gabohem kur them se është një fotografi e dokumenteve që keni marrë në 7 shtator 2020 nga OVL UÇK-ja; kështu?
Pë. [E padëgjueshme].
Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim faqen tjetër.
Py. Dëshmitar, a është kjo fotografi e të njëjtave materiale që i pamë pak përpara?
Pë. Po edhe kjo është fotografi e atyre dokumenteve.
Z. HALLING: [Përkthim] Faqen tjetër, ju lutem.
Py. Pyetja e njëjtë për ju z. dëshmitar, a janë të njëjtat materiale nga i njëjti grup dokumentesh?
Pë. Po.
Py. Dhe pyetja e njëjtë edhe njëherë për faqen e fundit. Të njëjta faqe prej të njëjtit grup dokumentesh?
Pë. [E padëgjueshme].
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Halling, si mbas evidencës që kemi ne, ky dokument nuk ka atë shtesën MFI po është provë e pranuar.
Z. HALLING: [Përkthim] Më vjen mirë që ma thatë këtë sepse unë kam mbajtur shënim ndryshe.

Z. REES: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim në lidhje me këto artikuj që u paraqitën që ka shkruar dëshmitari.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. HALLING: [Përkthim] Ka një grup më të gjatë dokumentesh që do t'i paraqes me radhë. Dhe do të marrë më shumë se 10 minuta, këtë mund ta bëj nesër. Si të doni.

Mund ta filloj tani dhe pastaj të vazhdoj nesër. Si të më thoni ju.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon].

Z. REES: [Përkthim] Një çështje kemi ne për të ngritur, të nderuar Gjykatës, thjesht t'ua përkujtoj.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon] A mund të na thoni se për çfarë bëhet fjalë?

Z. REES: [Përkthim] Ka të bëjë me urdhrin gojor që u dha në lidhje me dy -- me Shënimet Zyrtare që kanë bërë dy punonjës të ZPS-së dhe që nuk ishin përfshirë dhe për të cilat ZPS-ja duhej të jepte një farë indikimi deri nesër. Neve na u dha urdhër që të japim qëndrimin tonë sot.

Dhe thjesht po e bëj këtë që të jemi të qartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju po thoni se nuk keni marrë një koment nga Prokuroria në lidhje me këtë apo jo?

Z. REES: [Përkthim] Kemi marrë. Mirëpo na duhet një tregues prej jush në lidhje me përgjigjen tonë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sa do t'ju duhet?

Z. REES: [Përkthim] Jo shumë kohë. Ndoshta disa minuta. Duke marrë parasysh indikimin që kemi nuk do të na duhet shumë kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta lejoj z. Berisha që të përfundojë për sot.

Z. Berisha, nesër duhet të ktheheni në orën 09.30 minuta për të vazhduar me dëshminë tuaj. E keni këtë të qartë? E çmojmë që erdhët sot për të dhënë dëshmi dhe për t'i diskutuar këto çështje. Tani lejoheni të largoheni nga salla. Ndihmësja do t'ju ndihmojë.

z. Koci, ju faleminderit edhe juve që ishit i pranishëm.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Koci, jeni i lirë të largoheni dhe ju.

Z. HALLING: [Përkthim] Përpara se z. Rees të bëj parashtrimin e tij, tani, përkthimi për të cilin fola në fillim është nxjerrë.

Z. CADMAN: [Përkthim] E konfirmoj që e mora, por duke mos qenë folës i shqipes, duhet të marrë udhëzime për të.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në mëngjes do të merrni përgjigje.

do të merrni përgjigje.

Z. CADMAN: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z. Rees.

Z. REES: [Përkthim] Dje morëm njoftim nga ZPS-ja për një kërkesë me shkrim, që quhet kërkesa e dytë e Prokurorisë për të shtuar dëshmitarë, në listën e saj me shtojca konfidenciale. Me numër 00316 deri në 362.

Vendimi për synimin e ZPS-së është që të kërkojë leje për të shtuar një dëshmitar nga dy që ishin përmendur në urdhrin tuaj me gojë. Jo ose njëri ose tjetri, jo të dy, po njëri, njeri prej tyre W04876. Dhe kërkesa e tejkalon objektin e përcaktuar nga Trupi Gjykues në urdhrin e tij i cili e bënte të qartë se Prokuroria ju dha leje të mendonte që të thërriste dy dëshmitarë për qëllime të caktuara, të kufizuara.

Dhe ne na thatë që në fund të ditës së punës sot, duhet të tregonim nëse kishim ndonjë kundërshtim për këta dy individë që duhet t'i shtohen listës së dëshmitarëve. Në përputhje me këtë urdhër, ne duam të vëmë në dukje se kundërshtojmë kërkesën e hollësishme për të thirrur një prej dëshmitarëve dhe për të shtuar prova dhe për të marrë dëshmi që e tejkalon fushëveprimin e urdhrit tuaj.

Nuk kemi pasur shumë kohë për t'u përgjigjur me hollësi me shkrim për atë që nuk jemi dakord, për atë që nuk është një kërkesë e drejtpërdrejtë. Po në qoftë se ju doni që ne t'i

përgjigjemi me shkrim dhe jo me gojë do të kërkonim kohë të mjaftueshme ta bënim.

Sigurisht, ZPS-ja ka pasur gjashtë ditë të plota për ta përcaktuar qëndrimin e vet, kurse ne kemi më pak se 24 orë të përgjigjemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A mund të përgjigjeni plotësisht deri të enjten?

Z. REES: [Përkthim] Po, në varësi të punës tjetër që parashikohet të bëjmë. Por në qoftë se, siç e parashikoj unë, siç e kuptoj unë, që do të mbarojmë me këtë dëshmitar dhe nuk do të kemi dëshmi të tjera të drejtpërdrejta, atëherë po. Do të ishim mirënjohës për kohën që na jepni.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Që ta kuptoj, Prokuroria kërkon të sjellë një prej dy dëshmitarëve?

Z. HALLING: [Përkthim] Po është e saktë. Një gjë tjetër është se nuk kemi kundërshtim që Mbrojtja të paraqesë parashtrimet të tjera. Ky dëshmitar nuk do të zgjasë një javë dhe dëshmitari tjetër 04842, mund të fillojë të enjten.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ku e bazoni kundërshtimin tuaj? Në përgjithësi do të lejoheni të bëni një rekomandim me shkrim por dua të dëgjojë mendimin tuaj tani. Ju thoni që njeri pranohet, dy s'pranohen?

Z. REES: [Përkthim] Duke pasur parasysh kërkesën që kemi përpara, në qoftë se do të kishim një kërkesë tjetër për të

marrë dëshmi nga dy dëshmitarë, do ishte ndryshe. Në këtë rast ne kundërshtojmë. Së pari, gjendjen e nxjerrjes së materialit lidhur me dëshmitarët që propozohen t'i shtohen listës, W04876.

Kundërshtojmë propozimin lidhur me objektin e dëshmisë së këtij dëshmitari për shkak të natyrës së kufizuar të rolit që ka bërë ai përkundrejt asaj që propozohet të pyetet.

Ne kundërshtojmë mënyrën sesi është përgatitur dëshmitari, duke u referuar p.sh., pjesëve të ndryshme të urdhrit për kryerjen e procedurave, që është parashtrimi F00314, sidomos në lidhje me frymën e letrës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mjafton që të na njoftoni për bazën ku e mbështesni kundërshtimin tuaj.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Keni deri të enjten për të parashtruar përgjigjen tuaj me shkrim. Mund të dërgoni një përgjigje të konsoliduar që të mos përsërisni njeri-tjetrin. Kështu që me qëllim të premten ta trajtojmë.

Z. REES: [Përkthim] A mund të trajtojmë pastaj punën që do të bëjmë gjatë kësaj jave vazhdimin. U habitëm pak në fakt që ZPS-ja sapo njoftoi që kanë synim të thërrasin një punonjës W04842 këtë javë, pas përfundimit të z. Berisha.

Sigurisht, ne e kemi ngritur çështjen e mungesës së deklaratës së dëshmitarit që të mbulojë këto tre fushat. Dhe për këtë kur kemi kërkuar një vendim nga ana juaj. Në qoftë se

dëshmitari do të ishte i disponueshëm, unë s'e kuptoj sinqerisht pse nuk i kërkon t'i japi deklaratë, por unë po pres vendimin tuaj për këtë çështje.

Por do të na vendoste në vështirësi për tu përgatitur për pyetjet tona. Sigurisht është vështirë sesi mund ta përfundojmë dëshminë e këtij dëshmitari. Në qoftë se ai kur të thërritet ai të trajtojë çështjet kryesore, që të kuptojmë se çfarë dëshmie do të japë, por nuk mund të paraqesë një listë me provat tona apo prezantimet tona duke mos e ditur se çfarë do thotë ai.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Përpiqemi të tregohemi të arsyeshëm sa herë është e nevojshme. Në qoftë se ju duhet më shumë kohë do t'jua japim këtë kohë. Por ne do të donim të përfundonim paraqitjen e provave nga Prokuroria këtë javë. Nëse nuk mundemi, nuk mundemi. Por ne do të takohemi përsëri të enjten dhe të premten e javës që vjen dhe mbase do të përfundojmë atëherë.

Prandaj, të trajtojmë këtë çështje që kemi. Prokuroria do të thërresë ata dëshmitarë që mund të thërrasë. Unë nuk e di nëse ju do të bëni pyetjet tuaja.

Z. REES: [Përkthim] Unë po ju jap një paralajmërim, si të thuash, sepse po qe se do të vinim në atë fazë, atëherë, mbase nuk do t'i bëjmë pyetje atij punonjësi dhe do t'i bëjmë javës që vjen.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të

shikojmë ku jemi, do të shikojmë. Nuk duam t'ju vendosim në pozitë të vështirë. Po përpiqem të mos e bëj këtë.

Ora është 16.00.

Z. Cadman, më falni nuk ju pashë.

Z. CADMAN: [Përkthim] Sa për të sqaruar punën e planit të punës. Ju thatë që do të mblidhemi të enjten dhe të premte. Unë mendova se do të punonim të mërkurë dhe të enjte dhe jo të enjte dhe të premte.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo, jeni korrekt. Jemi normalisht të detyruar të punojmë sepse këto janë kushtet. Përkthyesit punojnë në ditë dhe me orë të caktuara. Pra, do të punojmë të enjte dhe të premte, siç thashë, javës që vjen.

Shihemi nesër përsëri në orën 09.30, këtu sot përfundojmë.

--- Seanca përfundon në orën 16.02